

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5624
E premte, 9 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Komisionari Hahn në dhjetor viziton Kosovën



REPUBLIKA E KOSOVËS NUK E SHEH MË TË NDARË PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE ME PROCESIN E DIALOGUT QË PO ZHVILLOHET NË BRUKSEL ME SERBINË

Kosova paralajmëron ndërprerjen e dialogut me Serbinë nëse nuk ka liberalizim të vizave



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe zëvendësi i tij, Enver Hoxhaj, kanë përmendur mundësinë e ndërprerjes së dialogut me Serbinë nëse Këshilli i Ministrave të BE-së në muajin dhjetor nuk e vendos në agjendë çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ata e kanë vlerësuar të arsyeshëm ndërlidhjen e këtyre dy proceseve në qoftë se BE-ja nuk e mban premtimin e dhënë për vizat. Sipas tyre, nuk është e drejtë që Kosovës t'i bëhet presion për dialog duke ua mohuar qytetarëve të saj të drejtën për të lëvizur pa viza në Zonën Shengen

O'Connell: Disa vende kanë tërhequr njohjet e tyre për Kosovën



Ahmeti shkarkon drejtorët e Vetëvendosjes, vendimi i tij konsiderohet qyqar

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**MINISTRIA E DIASPORËS
KONSULTON
BASHKATDHETARËT PËR
LIGJIN E DIASPORËS** F. 6

**PASTROHET LOKACIONI AFËR
KOMPLEKSIT UNIVERSITAR,
GJENDEN EDHE SHIRINGA E
MBETJE SHTAZORE** F. 7

**KOMUNA E MALISHEVËS PRIN
NË PUNËSIM TË PUNËTORËVE
ME NEVOJA TË VEÇANTA** F. 10

EKONOMI

**KMDLNJ-ja KËRKON QË
TAKSA NDAJ PRODUKTEVE
TË SERBISË TË RRIKET
NË 50 PËR QIND** F. 9

**KOSOVA DHE SHQIPËRIA
KOORDINOJNË PUNËT
PËR MIRËMENAXHIMIN
E UJËSJELLËSVE** F. 8

KULTURË

**NJË LIBËR QË SJELL
MESAZHE EDUKUESE E
KËSHILLUESE PËR FËMIJË** F. 13

Izet ABDYLI

SPORT

**FERIZAJ NUK LARGOHET
NGA SUPERLIGA** F. 15

**KOMUNA E PRISHTINËS
DYFISHON BUXHETIN
PËR SPORT** F. 15



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Të enjten në Bruksel pas tre muajsh ka vazhduar dialogu për normalizimin e raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit

Thaçi: U pajtuam për arritjen e marrëveshjes ligjërishit obliguese

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi pas takimit që pati me Përfaqësuesen për Politikë të Jashtme të BE-së, Federica Mogherini, ka thënë se u pajtuam për dinamizimin e dialogut dhe arritjen e një marrëveshjeje ligjërishit të obligueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



është e rëndësishme. Gjithçka tjetër nuk është për krahasim", tha Vuçiqi.

Pas më shumë se tre muajsh Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Federica Mogherini ka ftuar në Bruksel presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe atë të Serbisë, Aleksandar Vuçiq për të vazhduar me procesin e dialogut, i cili si synim ka normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Para këtij takimi, presidenti i Kosovës është kritikuar nga opozita për përfaqësimin e Kosovës në këtë dialog. Sipas opozitës, Thaçi nuk e ka mandatin e Kuvendit që të udhëheqë me procesin e negociatave me Serbinë. Po ashtu, edhe ideja e prezantuar e Thaçit për, siç e quan ai, "korrigjim të kufirit", nga opozita është cilësuar vetëm si kamuflim i idesë për shkëmbim të territoreve, çka është kundërshtuar ashpër.

Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, pret që, siç thuhet, të dy presidentët të konfirmojnë gatishmërinë e tyre për intensifikimin e punës për të arritur një marrëveshje të detyrueshme ligjore për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve, që është thelbësore për rrugën e tyre evropiane.

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi në kuadër të dialogut Prishtinë-Beograd me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, pas takimit që pati me Përfaqësuesen për Politikë të Jashtme të BE-së, Federica Mogherini, ka thënë se u pajtuam për dinamizimin e dialogut.

"Sapo e përfundova takimin bilateral me Përfaqësuesen e Lartë për Politikë të Jashtme të BE-së, Federica Mogherinin. U pajtuam për dinamizimin e dialogut dhe arritjen e një marrëveshjeje ligjërishit të obligueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar presidenti Thaçi në Facebook.

Shefja e diplomacisë evropiane, Frerercia Mogherini është takuar ndaras edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e më pas pritët të ketë takim trepalësh, darkë pune, mes Thaçit, Mogherinit e Vuçiqit në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Para takimit, të dy presidentët kanë paralajmëruar se bisedimet

do të jenë të vështira.

Thaçi: Procesi i dialogut nuk është i lehtë, do të bëhen përpjekje për arritjen e një marrëveshjeje

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, para takimit me kryeministrin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Bruksel ka thënë se pret që nga ky takim të përafrohen qëndrimet në interesin e arritjes së marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë.

Ai ka thënë se ky proces nuk është i lehtë. "Sonte jemi këtu për të zhvilluar takimin e radhës të procesit final të mundësisë së arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo është një marrëveshje obliguese në rrafshin ndërkombëtar. E di se nuk do të jetë e lehtë, ka vështirësi, ballafaqime, por arritja e marrëveshjes është mundësia për të lëvizur përpara", ka deklaruar Thaçi në konferencën me gazetarë në Bruksel.

"Do të bëhen të gjitha përpjekjet që të përafrohen qëndrimet në interesin e arritjes së marrëveshjes. Kjo është një mundësi e radhës e udhëhequr nga Mogherini dhe BE-ja me mbështetjen e plotë të ShBA-së. Synimi i Kosovës është që të kërkojë fqinjësi të mirë me të gjitha vendet, edhe me Serbinë", ka thënë Thaçi.

Edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në prag të takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, tha se pozicioni i Serbisë është i vështirë.

"Nuk më ofron rehati dhe nuk më pëlqen të bisedoj me Thaçin, por më mirë të bisedojmë njëqind vjet sesa të luftojmë një ditë. Kjo është puna ime. Paqja

Pacolli, Daçiqit: Duhet të ndiheni të turpëruar



PRISHTINË, 8 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka reaguar ndaj një deklaratë të homologut serb, Ivica Daçiq, i cili ka thënë se Interpoli do të mbushet me fletarrestime për udhëheqësit e Kosovës.

Pacolli nëpërmjet llogarisë se vet në "Facebook", i ka thënë Daçiqit se duhet të ndihet i turpëruar për gjenocidin serb në Kosovë.

"Njerëzit e Kosovës vetëm janë mbrojtur nga gjenocidi dhe nuk turpërohemi asnjëherë për

veprimet tona. Të turpëruar para civilizimit botëror janë ata që kanë kryer gjenocid", ka shkruar Pacolli.

"E lexova një deklaratë të Daçiqit, se gjoja Interpoli do të mbushet me fletarrestime për udhëheqësit e Kosovës. Po, mund të ndodhë që Serbia të vazhdojë të keqpërdorë edhe institucione ndërkombëtare, ashtu siç ka vepruar deri tani. Nuk është çudi, duke e ditur se kush është Daçiqi.

Njerëzit e Kosovës vetëm janë mbrojtur nga gjenocidi dhe nuk turpërohemi asnjëherë për

veprimet tona. Të turpëruar para civilizimit botëror janë ata që kanë kryer gjenocid. E mira është që askush nuk do të ketë mundësi më të kryejë gjenocid mbi popullin e Kosovës. Asnjë qytetar i Kosovës nuk është i dënua për vrasje. Asnjë qytetar i Kosovës nuk është i dënua për masakra. Asnjë qytetar i Kosovës nuk ka bërë krime lufte, ngase lufta jonë ka qenë për mbijetesë. Ndërsa bashkideologët e Daçiqit, nuk arrin t'i numërojnë kriminelët e luftës që kryen krimet e tmerrshme në Kosovë e rajon!", ka shkruar Pacolli.

Komisionari Hahn në dhjetor viziton Kosovën

Prishtinë, 8 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Komisionari

evropian i Zgjerim dhe fqinjësi Johannes Hahn, do ta vizitojë Kosovën në fillim të dhjetorit.

Kjo vizitë sipas Haradinajt

përçon mesazhin se Kosova është kandidat serioz potencial për status të kandidatit në BE, sado që ka pranuar se ka ligje më specifike që kërko-

jnë votë të posaçme. Haradinaj ndër të tjera pranoi se ka hezitim që Kosova të futet në agjendë e BE-së për liberalizimin e vizave.



O'Connell: Disa vende kanë tërhequr njohjet e tyre për Kosovën

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, Ruairi O'Connell, ka bërë me dije të enjten se disa shtete kanë tërhequr njohjet e tyre për Kosovën por, sipas tij, nuk ka ndonjë justifikim për këto veprime. Megjithatë, diplomati britanik ka thënë se Kosova i përmbush të gjitha kriteret për të qenë shtet i pavarur dhe, si i tillë, është pranuar nga Britania. Ndërkaq Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka mohuar që ndonjë vend të ketë marrë vendim për tërheqje të njohjes



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, Ruairi O'Connell, ka thënë të enjten se disa shtete i kanë tërhequr njohjet e tyre për shtetin e Kosovës. Ai ka theksuar se nuk ka ndonjë justifikim për këto veprime dhe sovran. "Fatkeqësisht, disa vende i kanë tërhequr njohjet e tyre për Kosovën. Nuk mendojmë se ka ndonjë justifikim për këto veprime. Kosova i përmbush të gjitha kriteret për të qenë shtet i pavarur dhe sovran. "Fatkeqësisht, disa vende i kanë tërhequr njohjet e tyre për Kosovën. Nuk mendojmë se ka ndonjë justifikim për këto veprime. Kosova i përmbush të gjitha kriteret për të qenë shtet i pavarur. Ne e kemi pranuar Kosovën si shtet i pavarur dhe sovran", ka deklaruar O'Connell në një bashkëbisedim me qytetarë në profilin e vet në "Facebook".

Më tutje, ai ka thënë se është e rëndësishme që Kosova të fokusohet në dy procese të mëdha që i ka përpara siç është anëtarësimi në Interpol dhe transformimi i FSK-së. "Në përgjithësi Kosova duhet t'i rregullojë marrëdhëniet me fqinjët. Vetë fakti se po flasim për tarifa, situata na tregon neve sa e rëndësishme është që Kosova dhe Serbia t'i normalizojnë marrëdhëniet e tyre. Kur Kosova dhe Serbia të kenë marrëdhënie normale bilaterale si dy shtete të pavarura, atëherë gjërat do të jenë shumë më të lehta për të dyja palët. Ne as që do të diskutonim për këto çështje. Mendoj se është e rëndësishme të vazhdojmë të fokusohemi në gjërat e mëdha të cilat Kosova po i kërkon. Mos të harrojmë se Kosova tani po shkon drejt dy proceseve të mëdha, atë të anëtarësimit në Interpol dhe planeve për transformimin e FSK-së", është shprehur O'Connell, duke

shtuar se anëtarësimi në Interpol është i rëndësishëm nëse ka luftë serioze ndaj krim-it të organizuar. "Unë nuk do të komentoj se çka bën Serbia. Sa i përket Britanisë, është e qartë që mënyra më e mirë për të shkuar përpara është që Kosova dhe Serbia ta njohin njër-tjetrën si shtete të pavarura dhe sovra-ne. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim. Kosova ka bërë përparime në vitet e fundit duke u anëtarësuar në organiza-ta ndërkombëtare. Kjo është shumë e rëndësishme. Anëtarësimi në Interpol është veçanërisht i rëndësishëm nëse ne jemi seriozë në luftën kundër krim-it të organizuar. Arsyja e vetme pse mund të kundërshtohet është nëse ju doni ta ndihmoni krim-in e organizuar. Është kaq e thjeshtë. Shpresojmë që të gjitha shtetet do ta përkrahin anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Ne do të vazhdojmë ta mbështesim Kosovën sepse kjo gjithmonë ka qenë mënyra më e mirë për paqe në rajon, duke përfshirë edhe Serbinë", ka thënë ambasadori britanik. Diplomati Ruairi O'Connell, në kuadër të këtij bashkëbisedimi me qytetarë, u ka bërë thirrje të gjitha partive politike parlamentare në vendin tonë që të bëhen pjesë e procesit të dialogut Kosovë - Serbi. "Duhet të jetë e qartë në fillim se ne mbështesim fuqishëm përpjekjet e përfaqësueses së lartë të BE-së, Mogherini, për ta lehtësuar procesin e normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Mungesa e marrëdhënieve bilaterale, normale dhe pozitive mes dy shteteve, i lë mbra-pa jo vetëm këto dy shtete, por edhe rajonin. Është vërtet pozitive, duke falënderuar edhe angazhimet e presidentit Hashim Thaçi, që tani ka energji dhe fokus në këtë çështje. Është tejet e rëndësishme të

kemi një proces që do ta përparojë Kosovën, ta përmirësojë stabilitetin e rajonit dhe që të jetë i zbatueshëm në Kosovë. Debatet e fundit në Kuvend janë hap i mirë, por secila parti duhet të përfshihet dhe të përdorë këtë mundësi për të ardhur deri te një marrëveshje. Takimet janë veç takime, por çka është e rëndësishme është angazhimi politik, duke kontribuar me ide se si të ketë një zgjidhje përfundimtare", ka thënë ambasadori O'Connell. Ambasadori O'Connell ka mohuar që Britania e Madhe e mbështet më shumë Serbinë sesa Kosovën. Sipas tij, Qeveria britanike mbështet të dyja vendet dhe zhvillimin e tyre. "Normalisht që nuk e mbështesim Serbinë më shumë sesa Kosovën. Ne kemi nevojë që edhe Kosova edhe Serbia të jenë dy shtete të forta dhe funksionale me demokraci evropiane dhe marrëdhënie normale. Ky do të ishte shpërblim i madh. Nëse marrëdhëniet zgjidhen, do ta ndihmojnë këdo në Kosovë dhe në Serbi. Normalisht duhet të zgjidhet në mënyrë të përshtatshme, në linjë me vlerat evropiane dhe duke përmirësuar stabilitetin rajonal", ka theksuar ai. Qytetarët kanë shprehur interesim të madh sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, madje kanë thënë se Bashkimi Evropian po përdorë standarde të dyfishta në raport me Kosovën. Por një gjë e tillë është kundërshtuar nga

ambasadori O'Connell, i cili ka thënë se nuk ka standarde të tilla ndaj Kosovës. Sa i përket vendimmarrjes për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës, ai ka thënë se kjo çështje është në dorën e vendeve të Shengenit. "Kjo është çështje për shtetet e Shengenit. Britania e Madhe nuk është pjesë e Shengenit, prandaj dhe nuk është për ne të komentojmë. Shtetet e Shengenit janë të qarta që lufta kundër korrupsionit dhe krim-it të organizuar është me rëndësi për ta, prandaj është vitale për Kosovën të vazhdojë të tregojë që është serioze sepse kjo është mënyra e vetme që t'i bindë shtetet e Shengenit", është përgjigjur O'Connell. Ambasador Ruairi O'Connell është pyetur edhe për dëshpërimin që kanë qytetarët për situatën politike dhe vlerësimin e tij për klasën politike në Kosovë. Ai u ka thënë qytetarëve se diplomatët nuk janë ata që mund ta ndryshojnë vendin e tyre, por janë pikërisht qytetarët e Kosovës që mund ta bëjnë një gjë të tillë. "Nuk ka rëndësi se si e vlerësoj unë. Ajo që ka rëndësi është si e vlerësojnë qytetarët. Kam katër vjet që jap porosi të njëjtë. Nëse qytetarët dëshirojnë ndryshimin dhe nëse vlerësojnë se politikanët duhet të mbahen përgjegjës, atëherë ata duhet të flasin vetë dhe ta bëjnë ndryshimin. Askush nuk do ta bëjë këtë për ju. Mos prisni që bashkësia ndërkombëtare apo diplomatët ta bëjnë këtë. Por,

unë jam optimist. Flasi çdo ditë me qytetarët dhe e di energjinë e tyre, por për këtë duhet të kenë shpresë dhe besim që ata mund ta ndërtojnë një të ardhme më të mirë", ka thënë O'Connell.

Ambasadori britanik është pyetur nga qytetarët edhe për idenë për korrigjimin e kufirit. Për këtë çështje ai ka thënë se dihet cili është qëndrimi i Britanisë së Madhe që nga viti 2005. "Pse po pyetni kur ju e dini qëndrimin e Britanisë. Pozita jonë nuk ka ndryshuar që nga viti 2005", është përgjigjur ambasadori O'Connell.

Ndërkaq para dy ditësh Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës përmes një deklarate për media ka theksuar se Serbia përmes lajmeve të rreme po keqpërdorë edhe reputacionin e vendeve që e kanë njohur Kosovën. "Ministria e Punëve të Jashtme siguron publikun se ka informacion dhe korrespondencë nga burime të shumëfishta kredibile, nga aktorë globalë, informacion i cili na rikonfirmon atë që e kemi pohuar gjithnjë, që vendet në të cilat thirret Serbia, e mohojnë të kenë marrë apo të konsiderojnë të marrin vendim për tërheqje të njohjes. Më saktësisht, të gjitha vendet në të cilat thirret Serbia kanë konfirmuar që bëhet fjalë për lajme të rreme dhe se njohjet e tyre konform praktikës së marrëdhënieve ndërkombëtare janë akte të pakthyeshme", është thënë në deklaratën e MPJ-së.

Republika e Kosovës nuk e sheh më të ndarë procesin e liberalizimit të vizave me procesin e dialogut që po zhvillohe

Kosova paralajmëron ndërprerjen e dialogut



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe zëvendësi i tij, Enver Hoxhaj, kanë përmendur mundësinë e ndërprerjes së dialogut me Serbinë nëse Këshilli i Ministrave të BE-së në muajin dhjetor nuk e vendos në agjendë çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ata e kanë vlerësuar të arsyeshëm ndërlidhjen e këtyre dy proceseve në qoftë se BE-ja nuk e mban pretimin e dhënë për vizat. Sipas tyre, nuk është e drejtë që Kosovës t'i bëhet presion për dialog duke ua mohuar qytetarëve të saj të drejtën për të lëvizur pa viza në Zonën Shengen

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Zyrtarët më të lartë qeveritarë kanë filluar ta ndërlidhin procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendësi i tij Enver Hoxhaj kanë përmendur mundësinë e ndërprerjes së dialogut të Brukselit nëse Këshilli i BE-së nuk e vendos në agjendë vendimarrjen rreth liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ditën që ka ndodhur takimi i radhës në

Bruksel në mes të presidentit të Kosovës dhe atij të Serbisë, kryeministri Haradinaj ka thënë se BE-ja po i jep shumë rëndësi dialogut, duke e detyruar Kosovën të jetë pjesë e tij, mirëpo duke ua mohuar qytetarëve të saj të lëvizin pa viza. "Do të ishte shumë keq që njëherë palë, në këtë rast Kosovës, t'i thuhet të marrë pjesë në dialog e qytetarët e tu nuk kanë të drejtë të lëvizin pa viza. Thaçi është mirë të analizojë vetë se çfarë është duke bërë, a duhet të vazhdojë të shkojë në këto takime kështu apo duhet të pranojë që çdo agjendë e vendit të vet të varet

nga disponimi i vendit fqinj", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë për medie të enjten pas takimit të Këshillit Ministror për Integritim Evropian.

Kryeministri Haradinaj e ka pranuar se ka hezitime që çështja e liberalizimit të vizave të vendoset në agjendën e takimit të Këshillit të Ministrave të BE-së. Ai ka bërë me dije se, pavarësisht prej faktit se Kosova i ka kaluar dy faza të rëndësishme të procesit të liberalizimit, vlerësimin e Komisionit Evropian dhe votimin e Parlamentit Evropian për ta filluar dialogun, tani ka

t në Bruksel me Serbinë

me Serbinë nëse nuk ka liberalizim të vizave



dialogut për normalizim të marrëdhënieve të Kosovës. Ai ka vlerësuar se nëse BE-ja nuk e mban premtimin për liberalizim të vizave, atëherë pse duhet t'i besohet asaj se mund ta diktojnë vullnetin e Serbisë për ta njohur Kosovën. "Kosova është angazhuar dhe ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe Bashkimi Evropian ka premtuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës me plotësimin e këtyre kriterëve. Por, nëse sot ka hezitim nga disa kryeqytete të BE-së në lidhje me vendimmarrjen në këtë proces, pse Kosova duhet t'i besojë këtij institucioni në dialogun me Serbinë. Nëse BE-ja dhe shtetet anëtare nuk janë të afta t'u përmbahen premtimeve që i kanë dhënë vetë, pse duhet të besojmë se mund ta diktojnë vullnetin e Serbisë për ta njohur Kosovën?", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa një pjesë e opozitës ka kërkuar ndërprerjen e dialogut me Serbinë, duke e kritikuar presidentin e vendit se është duke i vazhduar takimet në Bruksel me homologun serb. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ka thënë të enjten se takimi në mes të Thaçit dhe Vuçiqit, pa u paralajmëruar disa ditë më herët, tregon se po synohet arritja e një marrëveshje të dëmshme për Kosovën.

Në një konferencë për medie ai ka deklaruar se prokuroria duhet të lëshojë fletarrestim për presidentin. "Duke marrë parasysh se ky person ka shkuar pa mandat atje, kryeministri ka dalë në një konferencë sot që nuk e di për këtë, me qenë një shtet qysh duhet dhe me pas një kryeprokuror qysh duhet, kryeprokurori menjëherë do të lëshonte thirrje, policia fletarrestim, që presidenti të shfaqej në gjykatë, në një intervistim dhe t'i bëhej me dije se veprimet që po i bën janë shkelje të Kodit Penal të Kosovës. Askush nuk ka mandat, aq më pak presidenti, që të shkojë dhe me një armik të Republikës së Kosovës të thotë se nuk ka vija të kuqe dhe është duke u biseduar gjithçka", ka thënë Konjufca.

Ai ka theksuar se një gjë e tillë është bërë që të mos i jepet mundësi reagimi Kuvendit dhe as shoqërisë civile. "Ky takim është paralajmëruar vetëm 24 orë para se të ndodhë. Dje pasdite u bë e qartë nga zyra e Mogherinit. Pra, është praktikë jo e rastësishme, sepse këta do të aplikojnë strategjinë që takimet t'i lajmërojnë vetëm disa orë para se të ndodhin,

dhe jo disa ditë më herët. Kjo po bëhet për disa arsye. Nuk i jep mundësi reagimit të opozitës, pra nuk e kemi rastin të reagojmë si në rastin aktual kur nuk jemi të njoftuar për takimin. Kjo bëhet për arsye se marrëveshja është fare pranë mes dy presidentëve dhe meqë kjo marrëveshje është në dëm të Kosovës, për të mos pranuar reagime, këto takime po mbahen të fshehura dhe sekrete", ka thënë Konjufca. Sipas tij,

është shqetësuese gatishmëria e presidentit Thaçi për të arritur një marrëveshje me Serbinë. Si përgjigje ndaj veprime destruktive të Serbisë karshi Kosovës në arenën ndërkom-bëtare, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për vendosjen e masës mbrojtëse për importin e të gjitha produkteve të prodhuara në Republikën e Serbisë dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Masa mbrojtëse nënkupton

taksën prej 10 përqindësh të të gjitha produkteve që importohen në Kosovë dhe kanë për vend të originës Republikën e Serbisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën. Kjo masë ndaj produkteve serbe është kundërshtuar nga BE-ja duke kërkuar heqjen e saj, mirëpo zyrtarët qeveritarë kanë këmbëngulur se kjo masë nuk do të hiqet derisa të ndalet ofensiva diplomatike e Serbisë ndaj Republikës së Kosovës.

Ahmeti shkarkon drejtorët e Vetëvendosjes, vendimi i tij konsiderohet qyqar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Drejtorët nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët janë shkarkuar nga kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë mbajtur të enjten një konferencë për medie dhe vendimin e Ahmetit e kanë quajtur "qyqarllëk politik". Në konferencën për media folën drejtori i Shëndetësisë, Arben Vitia, drejtoresha e Kadastrës, Nora Kelmendi dhe drejtori i Kulturës, Ylli Rugova.

Zyrtarët e IV-së theksuan se pesë vjetët e fundit nëpërmjet qeverisjes lokale të kësaj lëvizje është ndryshuar koncepti i qeverisjes në Prishtinë. Sipas tyre, Ahmeti jo vetëm se devijoi nga Lëvizja Vetëvendosje, por tani po tregon se po devijon edhe nga modeli i qeverisjes së kësaj lëvizje. Ata kanë

thënë se shkarkimi i tyre u bë përmes një emisioni televiziv që u shfrytëzua kundër Vetëvendosjes pa njoftuar apo biseduar paraprakisht me ta. Arben Vitia, që është edhe kryetar i Qendrës së Prishtinës i Lëvizjes Vetëvendosjes, ka treguar se Ahmeti ka muaj që nuk komunikon fare me drejtorët e Lëvizjes Vetëvendosje për punët e domosdoshme të komunës. "Kjo qeverisje u fitua me besimin dhe votën e qytetarëve, por edhe me angazhimin e mijëra aktivistëve dhe vullnetarëve në Lëvizjen Vetëvendosje. Tashmë është e qartë se kryetarit, pas fitimit të mandatit të dytë, nuk i bëhet vonë as për besimin e qytetarëve dhe angazhimin e aktivistëve por, fatkeqësisht, as për premtimet me të cilat e fitoi këtë mandat", ka deklaruar Arben Vitia.

Nora Kelmendi ka deklaruar

se Ahmeti nuk ka guxim të ballafaqohet sy me sy me drejtorët nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe tashmë ka mbetur përfundimisht qyqar në drejtimin e institucionit. "Vazhdimisht po i shmanget Lëvizjes, madje edhe largimin prej saj më herët e pati bërë me dije përmes një deklaratë në rrjetet sociale", ka thënë ajo.

Ndërkaq Ylli Rugova ka përsëritur qëndrimin e tij se edhe ai do të largohet nga detyra e drejtorit, edhe pse Ahmeti pati thënë se ndryshe nga dy të tjerët, nuk po e shkarkon atë. Po ashtu, drejtorët e Lëvizjes Vetëvendosje, me rastin e largimit nga këto pozita, kanë falënderuar të gjithë qytetarët, aktivistët, stafin e komunës, personalin e shëndetësisë dhe komunitetin artistik e kulturor, gazetarët dhe mediat e vendit për mbështetjen.



mungesë të gatishmërisë për ta vënë në rend dite këtë çështje nga ana e Këshillit të Ministrave. "Ne si Qeveria e Kosovës po insistojmë që kjo çështje të vihet në rend dite të Këshillit të Ministrave pavarësisht a votojnë për ose kundër. Nuk bën të paragjykohej rezultati dhe të mos vihet në rend dite. Unë besoj se po të hyjë në agjendë të Këshillit të Ministrave liberalizimi do të votohet" është shprehur Haradinaj.

Edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ditë më parë e ka ndërlidhur procesin e liberalizimit të vizave me procesin e

Kryetari i PLK-së viziton pjesën e veriut

MITROVICË, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Partisë Liberale të Kosovës (PLK), Skender Gashi, ka vizituar pjesën e veriut në Mitrovicë. Në pikën kufitare në Bërnjak është takuar me policinë dhe doganierët e Kosovës, me të cilët ka biseduar rreth lëvizjes së

lirë të njerëzve dhe mallrave që hyjnë dhe dalin në këtë pikë të kufirit. Po ashtu, Gashi ka vizituar edhe liqenin e Ujmanit, Gazivodën dhe Zubin Potokun. "Bëmë bisedë me një asamblist shqiptar, z. Lavdim Peci, dhe një asamblist serb të Komunes së

Zveçanit. Sipas tyre, çdo gjë ishte në rregull. Gjatë vizitës nuk hasem asnjë problem", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook", ku ka postuar edhe fotografitë gjatë vizitës në veri. Ai ka thënë se do të ishte mirë që vizita të tilla të bëhen më shpesh

edhe nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe nga çdo qytetar i thjeshtë. "Kjo tokë është pjesë e Republikës së Kosovës dhe këta kufij nuk mund të ndryshojnë sepse me këta kufij na kanë pranuar 114 shtete të botës, në mesin e tyre shtetet më të



fuqishme evropiane dhe perëndimorë", ka shkruar Gashi.

Ministri Berisha vizitoi kadetët e FSK-së në Akademinë Ushtarake në Kroaci

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, gjatë qëndrimit në Kroaci, ka vizituar Akademinë Ushtarake dhe Qendrën e Përgjithshme të Zhvillimit Ushtarak "Dr. Franjo Tuxhman", ku është pritur në takim nga gjenerali Mate Padjen me bashkëpunëtorë, si dhe ka zhvilluar një takim me kadetët e FSK-së të cilët janë duke vijuar shkollimin profesional atje. Me këtë rast, ministri Berisha është njoftuar nga afër për kapacitetet shkollore, edukative, arsimore dhe trajnuese të Qendrës së Përgjithshme për Zhvillim Ushtarak, si dhe me kuadrin

profesional dhe me mundësitë që ofron kjo qendër për Kosovën për përgatitjen dhe shkollimin e kuadrin ushtarak. Ndërsa gjatë takimit të përbashkët me kadetët e FSK-së, që studiojnë në këtë akademi, Berisha i ka përgëzuar ata për arritjet e tyre shkencore dhe i ka inkurajuar t'i vazhdojnë sukseset e tyre në dobi të detyrave që i presin, në të ardhmen në FSK, pas përfundimit të studimeve të tyre. Ndërsa kadetët e FSK-së janë shprehur mjaft mirënjohës për vizitën e ministrit Berisha, njëherësh ia kanë paraqitur atij disa kërkesa procedurale për të cilat ata kanë nevojë gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Kroaci.



Ministria e Diasporës konsulton bashkatdhetarët për ligjin e diasporës



**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Bashkatdhetarë të shumtë kanë qenë të pranishëm në Francë, Suedi, Zvicër, Kroaci, Turqi, në konsultimet publike të organizuara nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike për Projektligjin e Diasporës (MDIS). Këto konsultime publike, ku të pranishëm kanë qenë edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës me ftesë të ministrisë nga partitë në pushtet dhe ato opozitare, kanë për qëllim dëgjimin e sugjerimeve të bashkatdhetarëve tanë për Projektligjin e Diasporës, i cili planifikohet të miratohet deri në fund të këtij viti dhe ka për qëllim ta rregullojë edhe më mirë marrëdhënien ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe

diasporës sonë.

Gjatë konsultimeve publike janë shtruar një numër i madh i çështjeve, si: kartoni i gjelbër, mësimi i gjuhës shqipe, siguria e investimeve, funksionimi i qendrave kulturore, të gjitha këto të parapara në ligjin e ri të diasporës. Pas përfundimit të procesit të konsultimeve, këto komente do të diskutohen për të gjetur vend në ligjin e ri, i cili do të procedohet në Qeveri në fillim të muajit dhjetor dhe, më pas, edhe në Kuvendin e Kosovës për aprovim final.

Në vazhden e konsultimeve, MDIS-i, në bashkëpunim të ngushtë me misionet diplomatike të Republikës së Kosovës, do t'i organizojë takimet me bashkatdhetarët në Gjermani, Austri, Belgjikë, Itali, Mbretëri të Bashkuar dhe ShBA.

Mrika Thaçi emërohet koordinatore për procesin zgjedhor në degën e AAK-së në Podujevë

PODUJEVË, 9 NËNTOR (ER) - Pas konsultimeve me degën e Podujevës dhe konsensusit të plotë në këtë degë, të enjten, me vendim të Kryesisë së AAK-së, Mrika Thaçi është emëruar

koordinatore për procesin zgjedhor në Degën e AAK-së në Podujevë. "AAK-ja, duke i besuar këtë mandat znj. Thaçi, shpreh mbështetjen e plotë dhe gatishmërinë që bashkërisht t'i ristik-

turojë dhe forcojë strukturat e Degës së AAK-së në Podujevë, duke i shërbyer kësaj demokracisë së brendshme dhe demokratizimit", është thënë në njoftimin e AAK-së.



Është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Ministror për Integrim Evropian

Qeveria shton punët për përmbushjen e obligimeve për agjendën evropiane

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se nëse Kosova ngec në reformat drejt Bashkimit Evropian, atëherë ka ngecur zhvillimi ynë shoqëror në tërësi. Në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian kryeministri ka theksuar të enjten se prioritet i Kosovës është avancimi drejt Bashkimit Evropian



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se prioritet i Kosovës është avancimi drejt Bashkimit Evropian (BE). Në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian, ai ka thënë të enjten se nëse Kosova ngec në reformat drejt BE-së, atëherë ka ngecur zhvillimi ynë shoqëror në tërësi. Ai ka treguar se qëllimi i tij ka qenë diskutimi për zbatimin e agjendës ERA, pasi janë në përmbajtje të periudhës kohore të ERA 1 dhe rifillimin e ERA 2, që nënkupton prioritet e nxjerra për zbatim në një periudhë kohore para tyre. "Përkundër faktit se ka ekzistuar një fokusim në agjendën e reformës evropiane, prapëseprapë mund të konstatojmë se ka pasur disa ngecje dhe vonesa në zbatim, të ndërlydhura

edhe me mënyrën e marrjes së vendimeve ose me mënyrën e nxjerrjes në prioritet të këtyre temave", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se janë në rrethana kur mund të përmbillet ERA 1 dhe të fillojnë prioritetet e tjera. "Pas përmbajtjes së fazës së parë të ERA-s, Kosova po kalon në etapën e dytë të kësaj agjende, duke u përafuar kështu me mekanizmat e Bashkimit Evropian. Kërkoj që ERA2 të jetë e saktë dhe me afate reale kohore në implementim. Dinamizimi i punës dhe thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional është në shërbim të përshpejtim-it të rrugës sonë drejt Bashkimit Evropian", ka thënë Haradinaj. Kryeministri ka theksuar se pa marrë parasysh temat me të cilat preokupohet, ndoshta çdo institucione apo sektorë të caktuar, prapëseprapë nuk duhet harruar që tema bazë është vetë avancimi

i Kosovës drejt BE-së. "Nëse Kosova ngec në reformat drejt BE-së, atëherë ka ngecur zhvillimi ynë shoqëror në tërësi", është shprehur ai, duke shtuar se nga ky tregues vërtetohet se sa qytetarët, shoqëria, vendi ynë po i afrohen BE-së.

Ndërkaq ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se me qëllim të priorizimit të reformave, Qeveria e Kosovës dhe e BE-së kanë lansuar agjendën e reformave evropiane, ku ERA 1 parashihte zbatimin e 22

prioriteteve nga një varg institucionesh. Ministrja ka thënë se sa iu përket të gjeturave të raportit përfundimtar, është bërë punë e mirë, por mundet edhe më shumë, duke cekur se edhe pse disa masa që janë ndërmarrë si Qeveri, kanë ngecur në Kuvend me mosmiratimin e nismave legjislative. Pas takimit, kryeministri Haradinaj dhe ministrja Hoxha në një konferencë të përbashkët për media kanë konfirmuar se nga ky takim është miratuar në parim raporti ERA 1 dhe

lista e prioriteteve të dokumentit të ERA 2.

Kryeministri Haradinaj ka deklaruar se është bërë punë e mirë deri këtu, por që pret edhe më shumë angazhim nga të gjithë aktorët e përfshirë. "Me dinamikat e punës së Këshillit Ministror për zbatimin e prioriteteve të ERA-s do ta dërgojmë një porosi të mirë që Kosova është kandidate serioze, potenciale për një të ardhme të afërt për statusin e kandidatit për anëtarësim në BE", është shprehur Haradinaj.

Pastrohet lokacioni afër kompleksit universitar, gjenden edhe shiringa e mbetje shtazore

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Mbi 60 thasë me mbeturina janë larguar nga aksioni i së enjtes në Prishtinë, të cilit iu bashkuan dhjetëra vullnetarë për pastrimin e brezit të rrugës "Xhorxh Bush" dhe hapësirave afër Radio Kosovës dhe kompleksit universitar. Aksioni u realizua në kuadër të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën", e cila nga 15 shtatori deri më tani ka rezultuar me pastrimin e mbi 400 deponive ilegale të mbeturinave në tërë Kosovën.

Për ekipin e "Let's Do It" shqetësues ka qenë identifikimi i shiringave dhe mbetjeve shtazore në një hapësirë kaq të frekuentuar të kryeqytetit, ku kalojnë çdo ditë qindra qytetarë. Drejtori ekzekutiv i "Let's Do It", Luan Hasanaj, ka apeluar te qytetarët që të jenë të kujdesshëm me

mjedisin dhe t'u bashkohen aksioneve të pastrimit që po realizohen në kuadër të fushatës. "Sot jemi këtu në mes të qendrës së kryeqytetit, ku po shohim numër të madh të mbeturinave. Është pikërisht vend ku kalojnë numër i madh i qytetarëve. Vetë ne, qytetarët dhe institucionet, duhet të kemi kujdes me pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambientit sepse nëse nuk kemi, atëherë nuk kemi nevojë as ta pastrojmë. Aksioni ta pastrojmë Kosovën po vazhdon. Deri tash janë hequr mbi 400 deponi", ka thënë Hasanaj. Ai ka bërë me dije se të mërkurën ka përfunduar aksioni disaditor në Komunën e Vushtrrisë për pastrimin e deponisë më të madhe të mbeturinave në këtë komunë, nga e cila janë larguar mbi 300 kamionë me mbeturina. Po



ashtu, përfaqësues të "Let's Do It" kanë njoftuar se çdo ditë po vazhdojnë aktivitetet në kuadër të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën" për pastrimin e

deponive më të mëdha ilegale në tërë territorin e Kosovës si dhe aktivitetet e tjera për ngritjen e vetëdijes te qytetarët për ruajtjen e mjedisit dhe hedhjen e mbe-

tureve vetëm në vendet e lejuara.

Fushata "Ta pastrojmë Kosovën", e cila nisi më 15 shtator, do të vazhdojë deri më 15 dhjetor.

Hamza: Projekti Pro Tax 2, një nga projektet më të suksesshme të Ministrisë së Financave



PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Komiteti Drejtues i Projektit Pro Tax 2 ka mbajtur të enjten takimim e radhës të kryesuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës së Suedisë në Kosovë, si donatorë kryesorë të

këtij projekti. Në këtë takim u diskutua në lidhje me arritjet e shënuara për hartimin e legjislacionit për tatimin në pronë, informimin e tatimpaguesve, proceset e reja të punës, zhvillimin e sistemit të TI-së si dhe arritjet në komponentët e tjerë të projektit.

Me këtë rast, ministri Bedri Hamza ka shprehur falënderimet e tij të përzemërta për përfaqësuesit e Ambasadës së Suedisë në Kosovë, Agjencinë Suedeze të Tatimeve, Departamentin e Tatimit në Pronë, përfaqësuesit e Projektit Pro Tax 2 dhe i ka siguruar ata

se përkushtimi i tij për realizimin e objektivave të projektit nuk do të mungojë. Ministri Hamza dhe përfaqësuesit e Ambasadës së Suedisë në Kosovë vlerësuan lart rezultatet e arritura të Projektit Pro Tax 2 që, sipas tyre, është një nga projektet më të suk-

sesshme të Ministrisë së Financave, duke përfshirë reformën e ndërmarrë së fundmi në fushën e tatimit në pronë, me theks të veçantë implementimin e tatimit në toka, si një nga reformat më të rëndësishme për komunat e Kosovës.

Rrafshi i Dukagjinit mirëpret investitorët spanjollë



GJAKOVË, 8 NËNTOR (ER) - Bizneset spanjolle kanë vizituar Komunën e Gjakovës me kërkesë të Zyrës Regjionale të Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), ku kanë bashkëbiseduar rreth 100 kompani dhe kanë arritur edhe disa marrëveshje bashkëpunimi.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka thënë se kanë sjellë bizneset spanjolle në Gjakovë me qëllim që edhe në rajonin e Dukagjinit të ketë bashkëpunime dhe investime. Sipas tij, Dukagjini ofron mundësi të shumta për investime.

Bizneset spanjolle kanë takuar edhe kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, me të cilin kanë biseduar lidhur me mundësitë për investime. Kryetari Gjini i ka informuar bizneset spanjolle lidhur me potencialet që kanë për të bërë biznes dhe i ka ftuar ato

të realizojnë investime në Gjakovë. Ai ka premtuar se janë në krah të investitorëve dhe do të mbështesin çdo iniciativë të tyre. Alberto Garcia Rojas, udhëheqës i investitorëve spanjollë, ka pohuar se bizneset nga vendi i tij janë për herë të parë në Kosovë dhe janë të

interesuar të investojnë. Ai ka treguar se këtu janë 15 biznese nga industria e mishit, aluminit, elektrikes, ndriçimit, instalimit, lëkurës, përpunimit të këpucëve, të prodhimit të verërave, parfumerisë e detergjenteve, shërbimeve juridike etj.

KMDLNj-ja kërkon që taksa ndaj produkteve të Serbisë të rritet në 50 për qind

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka propozuar që taksa ndaj produkteve të Serbisë të rritet paku 50 për qind. KMDLNj-ja ka vlerësuar se mallrat nga Serbia e kanë vërshuar tregun e Kosovës dhe nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli sikur që skajshëm e kanë rritur informalitetin në ekonominë e brishtë të Kosovës



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar rreth vendimit të Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masës mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina. Kjo masë mbrojtëse nënkupton taksën prej 10-përqindësh të të gjitha produkteve që importohen në Kosovë dhe kanë për vend të origjinës Serbinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën. KMDLNj-ja ka vlerësuar se liria e lëvizjes dhe qarkullimi i lirë i mallrave, si të drejta elementare të njeriut dhe si garantues të zhvillimit ekonomik në Kosovë, po dhunohen brutalisht nga Serbia, e ndihmuar nga një pjesë e burokracisë së vendeve të BE-së, biznesmenët e kriminalizuar

kosovarë dhe një pjesë e kriminalizuar e politikës vendore. KMDLNj-ja ka propozuar që kjo taksë të rritet në masën së paku 50 për qind. "KMDLNj-ja propozon që kjo taksë të rritet së paku 50 %, sikur që të zbatohet 100 % reciprociteti me Serbinë dhe për këtë besojmë se do ta kenë mbështetjen e qytetarëve të Kosovës, pavarësisht çmimit që duhet ta paguajnë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj-ja ka vlerësuar se mallrat nga Serbia e kanë vërshuar tregun e Kosovës dhe nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli sikur që skajshëm e kanë rritur informalitetin në ekonominë e brishtë të Kosovës. "Vendosja e taksës doganore prej 10 përqindësh për mallrat nga Serbia dhe Bosnja është një veprim simbolik, afatshkurtër dhe më shumë një bluf politik për faktin se ndaj Serbisë dhe Bosnjës është dashur të ven-

dosen taksa në nivel që Serbia dhe Bosnja e dëmtojnë Kosovën në skenën ndërkombëtare dhe kjo është dashur të vendoset që nga koha e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur Serbia nisi një luftë të hapur për shkatërimin e Kosovës si në planin ndërkombëtar, po ashtu edhe në atë të brendshëm. Bashkësia ndërkombëtare është treguar e padrejtë ndaj Kosovës duke e lejuar Serbinë të ndërhyjë në mënyrë flagrante në punët e brendshme të një shteti, pavarësinë e së cilit e kanë njohur pjesa dërrmuese e këtyre shteteve", është theksuar në

reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, BE-ja po përdorë standarde të dyfishta dhe është dyfytërshe edhe sa i përket liberalizimit të vizave, duke vendosur kushte shtesë për Kosovën, të cilat nuk ishin kusht për asnjë shtet të Ballkanit dhe duke e shtyrë liberalizimin e vizave drejt kushtëzimit për lëshime politike që përmbajtësisht e dëmtojnë Kosovën. "Kushtëzimi si mjet për arritje të qëllimeve politike dhe të tjera është vepër penale e cila sanksionohet me ligjet e vendit dhe ato ndërkombëtare", është theksuar në reagimin e

KMDLNj-së.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka theksuar të mërkurën se Qeveria e Kosovës ka qenë e obliguar të ndër marrë masa ndaj importeve të shtetit të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës në mënyrë që t'i mbrojtë prodhuesit vendorë dhe që mos të falimentojnë bizneset vendore. Pavarësisht prej presionit të BE-së për ta shfuqizuar këtë masë, ministri Shala beson se Qeveria nuk do të tërhiqet nga vendimi i saj. "Besoj dhe shpresoj se Qeveria do të vazhdojë ta mbajë këtë masë", ka thënë Shala.

Kosova dhe Shqipëria koordinojnë punët për mirëmenaxhimin e ujësjetësve

TIRANË, 8 NËNTOR (ER) - Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë së Shqipërisë, Damian Gjiknuri, ministri i Zhvillimit Ekonomik i Kosovës, Valdrin Lluka, dhe ai i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, kanë marrë pjesë në konferencën e përbashkët të organizuar në Tiranë nga shoqatat e ujësjetës-kanalizimeve të dy vendeve. Shqipëria tanimë është vendi i parë në rajon që në kuadër të bashkëpunimit me USAID-in ka formalizuar një program për trajnimin dhe certifikimin e stafeve të shoqërive të ujësjetës-kanalizimeve.

Për këtë arsye në mes të ministrave Gjiknuri e Lluka u firmos edhe një memorandum i përbashkët përmes të cilit të dy vendet do ta shkëmbejnë përvojën e tyre me synim mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore. "Që të administrojmë siç duhet ujin duhet të kemi njerëz profesionistë e që dinë ta menaxhojnë këtë



pasuri kaq të rëndësishme. Ne në Shqipëri kemi filluar një reformë të rëndësishme për sa i përket mirëmenaxhimit të sektorit të ujit të pijshëm. Rezultatet e para kanë

qenë të mira. Është rritur arkëtimi me 17 milionë euro më shumë se vitin e kaluar për të njëjtën periudhë. Janë reduktuar ekspozimet e ndërmarrjeve të ujësjetës-

kanalizimeve ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë", u shpreh ministri Gjiknuri. Sipas tij, në kuadër të reformës së ujit është bërë e mundur që në periudhën

nëntëmuajore të këtij viti të installohen 74 mijë matës dhe 37 mijë kontrata të reja të nënshkruhen. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, vuri theksin te nevoja për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe shkëmbimin e përvojave pozitive për menaxhimin e sektorit të ujësjetës-kanalizimeve. "Kemi nevojë edhe ne në Kosovë për praktikantë më të mira që ofron Shqipëria, sidomos nga disa praktika të menaxhimit të ujërave të zeza. Prandaj, le të jetë kjo edhe një metodë e shkëmbimit të këtyre praktikave që mund t'i aplikojmë në vendet tona në mënyrë që bashkërisht t'i menaxhojmë ujërat sa më mirë", ka deklaruar Lluka.

Ndërsa ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka theksuar se konferencat e tilla janë mbështetje dhe shtytje edhe për ministrinë dhe qeveritë e dy vendeve.

Komuna e Malishevës prin në punësim të punëtorëve me nevoja të veçanta

MALISHEVË, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur të enjten në takim pune punëtorët me nevoja të veçanta, të punësuar në disa departamente të kësaj komune. Begaj ka thënë se këta punëtorë janë shembulli i shoqërisë sonë. "Jeni shembulli i të barabartëve në të gjitha fushat. Kjo dëshmohet me shkollimin akademik tuajin dhe cilësinë e shërbimeve që ua jepni qytetarëve gjatë orarit të punës. Unë do të vazhdojë t'ju mbështes edhe më tutje",

është shprehur Begaj. Të punësuarit Arben Krasniqi, i cili ka të përfunduar Fakultetin e Edukimit, Elfete Zogaj, sociologe dhe Atifete Gashi, ekonomiste, theksuan se Komuna e Malishevës prinë në punësim të punëtorëve me nevoja të veçanta para shumë komunave të tjera në Kosovë. Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, u zotua para tyre se do të vazhdojë edhe në të ardhmen ta ketë prioritet punësimin e kësaj kategorie të shoqërisë sonë.



Ahmeti premtan rimëkëmbjen e Pallatit të Rinisë

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka vizituar të enjten Pallatin e Rinisë, e para vizitë pas kalimit në pronë komunale. Ahmeti ka thënë se deri në fund të vitit do të ketë një ide më të qartë për rimëkëmbje, siç e cilëson ai, "gjiganti të Prishtinës". Kryetari i Prishtinës ka thënë se do të ketë disa faza, ku në fillim do të fokusohet në ato

emergjente që, sipas tij, janë pagesat e punëtorëve dhe borxhet e pallatit. "Do të ketë disa faza të rimëkëmbjes. Faza e parë është emergjente, duhet ta stabilizojmë, sa iu përket dhe pagave të punëtorëve, pastaj shlyerjes së disa borxheve, sepse borxhet arrijnë mbi tre milionë euro. Duhet ta riprogramojmë atë borxh", ka thënë Ahmeti. Ai ka theksuar se bashkë me aksionarët dhe drejtorin e

Pallatit të Rinisë do të diskutojnë disa projekte për rimëkëmbje të pallatit, ku përfshihen: parkingu që është te salla e djegur, Qendra Kulturore e Fëmijëve, ku janë Salla e Kuqe, Galeria, etj. Ndërsa drejtori i Pallatit të Rinisë, Ilir Dugolli, ka thënë se pas një kohe të gjatë Pallatit të Rinisë pritet t'i kthehet vlera. Sipas tij, ky pallat është gjendur në vështirësi të mëdha si me objekt, po ashtu edhe me paga të punëtorëve.

Komuna e Skenderajt subvencionon 200 fermerë

SKENDERAJ, 8 NËNTOR (ER) - Në praninë e kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nëpërmjet drejtorit për Bujqësi, Pyltari, Zhvillim Rural, Sokol Sallahu, drejtorit ekzekutiv të Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK), Zenel Bunjaku, dhe 10 fermerëve të kësaj komune, janë nënshkruar kontratat për mbështetje në sektorë të ndryshëm të bujqësisë. Kryetari Jashari është shprehur i lumtur me këtë mbështetje, duke premtuar se ndihma e komunës nëpërmjet subvencioneve do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Me nënshkrimin e 10 kontratave të tjera me fermerët tanë, nëpërmjet Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK), vetëm dy ditë pas atyre për serra, për mbështetje direkte në sektorë të ndryshëm të bujqësisë, kemi arritur numrin 200 të fermerëve përfitues nga komuna jonë, në më pak se një vit, falë mbështetjes nga buxheti komunal si dhe nëpërmjet granteve bujqësore nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare", është



shprehur ai. Katër fermerë kanë përfituar: mekanizëm bujqësor, mbjellëse misëri, plug, pajisje për bletari, grabujë diellore spërkatëse 400 litra dhe pijatore. Dy fermerë kanë përfituar serra nga dy ari për secilin. Katër fermerë kanë përfituar: bimë aromatike rigon, hithër, të kompletuar me sistemin e ujitjes pikë-pikë. Fermerët përfitues të bimëve aromatike do ta kenë tregun e siguruar për shitjen e bimëve.

"Po sot, me drejtorin ekzekutiv të Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë, Zenel Bunjaku, kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, për t'i mbështetur me grante bujqësore të riatdhësuarit, në kuadër të projektit 'Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale'. Urime fermerëve përfitues!", ka thënë kryetari Jashari.

Drenasi dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

DRENAS, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë, Zenel Bunjaku, me ç'rast kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Komuna e Drenasit dhe IADK-ja, me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK) në Komunën e Drenasit. Kjo marrëveshje ka për qëllim ta përshkruajë bashkëpunimin në mes të Komunës së Drenasit dhe IADK-së gjatë periudhës shtator 2018 - qershor 2020 për të drejtat dhe detyrat e palëve kyçe, ku si qëllim i fundit është ndihma dhe përkrahja e fermerëve të kthyer të cilët do të jenë në gjendje të prodhojnë



për nevoja të veta dhe për treg. "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK) është duke e zhvilluar projektin 'Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale' në Komunën e Drenasit dhe katër komuna të tjera, përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), i mandatu nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë", thuhet në komunikatën për media të Komunës së Drenasit.

(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /17/

Deklarata e Rexhep Avdullahut



Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

U prezantue Rexhep Avdullahu, nga Kabashi i mbiqujtun "Tomorr" i cili deklaroi e tha: "Mua me ka ngjitur këtë emën Tahir Deda, unë kam qenë sekretari i komunës në Lubizhdë. Tahir dedën e njohi qysh nga muaji kallnuer i vitit 1944 tuj kenë unë sekretar i komunës Lubizhdë kam pas punë me këshillin e rrethit të Prizrenit. Unë skam punue asgja, as nuk kam organizue ato 5 vet që shënohen në procesverbalin e hetuesisë. Unë me Tahirin jam takue për heren e fundit dy muaj e gjysmë para burgimit, i cili me foli atëherë: neve skemi të drejta e qi kam thanë unë se nuk asht ashtu. Unë kam ardhë javë për javë në Prizrenmbasi ishna anëtar i partisë komuniste qysh prej muajit fruer ose mars 1945. Me Tahirin kam pas bisedue para se me hy në P.K. Për Ymer Devetakun kam ndigjue si një katundar trim. Nebi Sahiti asht prej Kabashi dhe skam pas kurrëfar lidhje me te.. Për Shaban Polluzhën, Smail Goranin, Ibrahim Lutfiun kam ndegjue. Pseudonimin "Unë" ka qenë i Tahir Dedës. Nuk asht e vertet qe unë skam lejuë të arrestohet Nebi Sahiti. Në muajin nënduer jam takue me Tahir Dedën. Kam thanë se Nebi Sahiti ka mbajt postën e Tahir Dedës. Që e kamë deklarue se Nebiu asht shoku i im, kam deklarue kot.

Me Tahir Dedën jam takue 4-5 herë. Të katërten herë më tha: "na mungojn të drejtat" atëherë ka qenë muaji fruer, unë i thash se e kemi dhe jemi da; biseda tjera nuk kam ba. Abdyl Rexhepi e kam të njoftun prej 1912 në Suharekë mbasi ka qenë nëpunës në Financë, por skam ba me te asnjë bisedë. Për Xhemë Gostivarin kam ndigjue porse çfarë njeri ka qenë këte nuk e di. Kryetari: A ke punue dishka në organizatën e KND.

I pandehuri: Po, Punue skam por e kam ditë punën e Tahir Dedës që do të bante këshu. Deklaroi njilash se ato qi i kam deklarue në procesverbalin e hetuesisë janë të vërteta, deri në këtë moment kam kenë i hutuam dhe kërkoi të bahet gjykimi i fsheht.

Prokurori: Shoku kryetar, propozoi që të bahet gjykimi i msheft.

VENDIMI:

Simbas kërkesës të Prokurorit publik si dhe të pandehurit Rexhep Avdullahit, mbi vazhdimin e gjykimit me dyer të mbylluna pëlqehet dhe vendoset që të përrjashtohet publiku nga salla e gjyqit.

Deklarata e Ruzhdi Kabashit:

U prezentue i pandehuni Ruzhdi Kabashi, nxanës nga Prizreni i cili deklaroi e tha. Mua me ka dergua një letër Sali Zhuri të cilin e njohi pasi e kam pas shok shkolle, ai asht anëtar i ballit kombëtar dhe ka qenë një nga shtyllat ma të forta të organizatës balliste. Saliu qysh prej fillimit të lirimimit të Kosmetit asht në arrati. Përmbajtja e letrës ka qenë: Ti Ruzhdi ke qenë kundra nesh por besoi se sot do të jesh me ne. Këtë letër e ka dergje me Sallaudin Hivzin, kuriri erdhi me marr pergjegjen e letrës por unë nuk i dhash. Sallaudini me shpjegoi se Muharrem Bajraktaeri ka shkue në Bari për me rregullue çështjen e Kosovës. Unë e disha se ska gja prej kësaj pune. Vetem Eshref Shefqeti me ka vet se a di me punue me radiostacion, unë i thash se di por mungojn disa vegla, radion nuk e kam rregullue Shefqeti me tha: "a je i zoti të punojsh me një radio stacion. Ma vonë me kanë vet prej organizatës së Prizrenit, po unë iu thash se nuk di. Unë skam pranue me rregullue kete radiostacion skam dijeni se ku e kanë gjetë radion. Për Luzë Ndreçin qe ka shkue në mal kam marr vesh Sallaudinit. Unë në shkollë kam qenë me antifashistat dhe jo me ballistat. Nji muaj ditë para burgimit tim Eshref Shefqeti me veti për radio telegrafistin. Për bisedat me Shefqetin dhe për letrat e Sali Zhurit nuk i kam tregue kërkuat.

Deklarata e Kadri Ramadanit:

U prezentue Kadri Ramadanit-Topalli, punëtor nga Prizreni, i cili deklaroi e tha: Sefedini një ditë më thirri me shkue në vreshtë, kur shkue në vreshtë e pash se ata ishin njerëz të malit e njofta Njazi Ali Shalën, kapiten Rizën edhe shumë tjerë që ishin me këta. Atje ka qenë edhe Fluku. Mue me ka fut në këtë organizatë vetë Sefa. Prej Prizrenit në mal kam shkue dy herë. Njihërë kam hik në mal, por ata të malit me thanë se sje për neve, unë pastaj u ktheva në sheher dhe u arrestova, këshu që ndejta vetëm një ditë në mal. Herën tjetër kam shkue në mal këshu, mbasi kam kenë në një dyqan ku më asht thanë se duhet me que një vajzë, kete gja ma tha e zonja e kapiten Rizës dhe me premtoi një napolon e gjysmë për këtë sherbim. Këtë punë e pranova mbasi ishna fukara. Unë nuk edi se kush ishte kjo vajzë. Ma vonë e

mora vesh prej ata të malit se kjo qenka drazhiste Mila Bilibajkiq. Emnin Kamber e kam ndigjue vetëm atë ditë që ishna në mal, nuk kam que në mal as municion, as bomba as gjana tjera. Në konferencën që asht mbajt në shtëpin e Palaqos skam hy ose kur hyna ata u shpërndan. Unë Riza kapitein e njofta që ishte në konferencë. Riza Kapiteni nuk ka qenë i veshun si hoxhë në këtë shtëpi. Nuk e di se kush asht kurim i Riza kapitenit. Laura më tha në burgun e Prizrenit: "Mos e poho se e ke të njohtun mue" Sefa me dha një pushkë me e que në shtëpin e tij e qi u ba 6-7 ditë para burgimit tim. Kjo pushkë asht gjetë ma vonë prej OZN-es. Sali Zhurin e pashë atë ditë në mal. Motren e tij Nesiben së bashku me Laura Shmanin kam shoqënuë prej malit në Prizren. Mila Bilibajkiqin e qova vetem për me marr qiran. Unë kam shkue prej Terzi mëhallës me thirrë Abdullah Hamzën për shtëpin e Sefës ku u ba atë natë konferenca.

Deklarata e Abdullah Hajrullahut-Abushit:

U prezentue i pandehuni Abdullah Hajrullahi-Abushi me profesion furrtar nga Prizreni, i cili deklaroi e tha: Nji muaj ditë para burgimit tim kam fillue me punue me kete komitet mue me kanë shti në këtë punë Sefedini dhe Sulejman Mallta, tue me thanë me shkue deri në vendin e quajtn Leon ku janë vneshtat. Unë shkova me Sefedinin në ora 12 ku kam ndigjue prej Sali Zhurit qi foli: Neve kemi marr 5 barrë bukë dhe 15 palë opinga, kurse juve po shkruan në këtë letër se po qoni 20 barrë drithë e 35 opanga.

Këto fjalë i drejtoi Sali Zhuri këtyre të organizatës dhe u kapen me fjalë. Salija dhe shokët e tij kërkofshin ndihma prej komitetit, kurse këta thoshin se nuk kanë. Unë jam vonue me këto në mal nja një gjysmë sahati. Sylejman Mallta me thoshte se do të bashkohemi me Shqipni, dhe me u marr vesht me "partizanët e malit", këto fjalë mi tha në dyqanin e vet. Heren e dytë kanë qenë Abdullah Hamza, Sylejman Mallta dhe Xhemil Fluku, i cili ka qenë kryetar i organizatës, kurse unë kam qenë ndihmës i Sylejmanit d.m.th. ndihmës i intendentit ose arkëtar. Mbledhja asht ba në shtëpin e Abdullah Hamzës Naxhi Ali Hasani asht i biri i Ali Hoxhës. Sejfedini ka qenë sekretari i komitetit Ija Shehi me Rasim Sadikun kanë qenë me ne. Xhemili tha "Unë kam me ba lidhje me komunat dhe me rrethet tjera dhe tue na thanë se aty ka lidhjet", ka kurorat. Rasimin e kanë ba për propagandë, ai e kishte për detyrë me trubullue, me ba parti në popull për interesin e atyne në mal. Xhemili urdhënpnte nëpër mbledhjet e

organizatës tonë. Shaban Gjakova ka qenë milic dhe kurim i komitetit. Në shtëpin e Abdullah Hamzës kemi ba betimin ku kemi qenë prezent 5 vet. Sulejman Mallta u frigue prej Sinan Hazërit i cili e kishte vëllaun oficer në armatën e Jugosllavisë e ky betim ka pas për qëllim që mos me tregue fjalët që u folën në këtë shtëpi popullit jashtë.



Deklarata e Abdullah Hamza-Palaqo:

U prezentue i pandehuni Abdullah Hamza-Palaqo, me profesion kafexhi, i cili deklaroi e tha: Mue në organizat me ka shti Sefa, mbasi me thirren me shkue në vresht per me u takue me Njazi Alishanin, i cili atë ditë kishte për të ardhur në një vend afër Leonit. Njazi Alishani ka kerkue drithë prej nesh. Me Sylejman Malltën kam qenë atë natë në kafe. Në mal kam qenë me të arratisunit vetëm 5 minuta dhe u largova menjëherë. Sylejman Mallta e ka thirr Abushin, Sinan Hazërin, Rasim Sadikun, Xhemil Flukun me ardhë në shtëpin time për me ba konferencën. Konferenca është mbajt në shtëpin time, gjatë konferencës unë kam ndejt afër portës së oborrit ku kam ba roje tue hy herë mbas herës në dhomë ku u bante biseda. Sulejmani mbas konferencës me tha se e kan zgjedhë për kryetar Xhemil Flukun. Unë nuk di asgja që të ketë caktua mue dikush si nënkryetar i organizatës të këtij komiteti në Jeni mëhallë, as qi s'kam qenë kryetar. Betimin e kemi ba të gjithë dhe unë bashk me këta, prej meje kanë kërkue që të mbledhi drithë për ata të malit për grupin e Njazi Alishanit. Sekretari komitetit ka qenë Sefedini. Unë nuk e di qi Prizreni ka que ndonji ndihmë për ballista. Në Leon kam shkue vetëm për me u takue me Njazi Alishanin.

Deklarata e Xhemil Flukut:

U prezentue i pandehuni Xhemil Fluku, i mbiqujtun "Komona" nga Prizreni, i cili deklaroi e tha: Quhem "Komona" qysh 35 ditë para burgimit, mbasi ka propozue kapiten Riza Alija, por asnjëherë skam muejt me kuptua randesin e këtij pseudonimi. Sulejman Mallta asht quejt "Gjymert", i cili ka qenë së bashku me ne në vendin e qujtun Renime, ku jam

takue me kapiten Rizën, Sali Zhurin, me disa kurora e me shumë të tjerë. Ali Riza me tha se me kishte thirrë mua që ta ndermjetësojsa pranë Xhavit Nimanit për me u marr vesh. Unë e di se kjo organizatë e jona asht qujt komitet dhe që jam kenë unë kryetar i kësaj. Hysen Rexhepi asht nga Kabashi, por unë nuk e njomi. Shaban Gjakova na ka propozue Hysenin që duhet të na sherbej si lidhje d.m.th. kurim Shabani ka prue një letër prej katundit Kabash të cilën e hapa unë por nuk e këndova mbasi ishte e shkruese në gjuhën shqipe, të cilën gjuhë unë nuk e di. Unë ma vonë e mora vesh në mal se katundi Kabash ka kerkue me pas lidhjen me Prizrenin. Prej Rahovecit kanë ardhë dy njerëz me Sulejman Malltën i cili më tha se e me keta të Rahovecit paskan formue një komitet siç kemi formue na në Prizren. Ali Rizës i kam shkruë një letër ku kam shpjegue se nuk mujta me u marr vesht. Kapiten Riza me tha se duhet me gjetë lidhjen diqysh me Muharrem Bajraktarin. Mustafiq Hajrullah me dha një letër prej Mustafë Dërgutit prej Rahoveci, i cili gjindet në mal. Kapiten Riza më tha se gjinden drazhistat në mal dhe prandaj duhet të merremi vesht me partizan. Kryetari i komitetit deri në fund kam qenë unë, tri herë kam qenë në mal dhe jam takue me Riza kapitenin, kam thirr Fehim Ibrahimin per me e shti në komitet, por ky me tha se: mos ma hap kete muhabet. Shaban Gjakova me tha se atje në Kabash ka një ish N. Prefekt, një ish sekretar, dy ish oficer shqiptar dhe një oficer gjerman. Për veprimet tona anëtarët e komitetit të Prizrenit nuk me kanë dhanë llogari dhe prandaj nuk e di a e kanë que ndonji ndihmë atyne në mal a po jo. Betimin e kemi ba në shtëpin e Palaqos. Nj letër prej Mustafë Dërgutit e kam marrë, Meto Ceniçi, Mustafiq Hajrullahu të dy nga Rahoveci kanë ardhë te unë me anën e Sulejman Malltës. Meta me pruni një letër të Mustafa Dërgutit, e cila ishte e shkruese në gjuhën serbishte. Në letëren tonë kemi shkruë se komiteti asht formue ktu në Prizren dhe se duhet të formojnë edhe ata. Ata të malit na thanë atë ditë kur u takuem se kanë marrë mangu sende që i kemi dergje ne. (Vijon)



Barnier: Ende ka shumë punë për të arritur pakt për Brexitin

BRUKSEL, 8 NËNTOR - Negociatori i Bashkimit Evropian për Brexitin, Michal Barnier, ka thënë se duhet mbushur të gjitha hapësirat për procesin e diskutimeve për largimin e Britanisë nga BE-ja, derisa është duke ecur koha dhe të dyja palët

janë duke bërë përpjekje për të arritur një marrëveshje. Barnier i ka thënë agjencisë së lajmeve, "The Associated Press", se "ne duhet të punojmë shumë" për të arritur një pakt. Megjithatë, pavarësisht prej përpjekjeve të vazhdueshme për lëvizjen e

mallrave në kufirin irlandez, palët nuk kanë arritur të gjejnë gjuhë të përbashkët.

Britania planifikon të largohet nga Bashkimi Evropian në mars të vitit 2019, mirëpo në mënyrë që të ketë marrëveshje pas Brexitit, ajo duhet të arrihet në

këto javë, në mënyrë që parlamentet përkatëse të kenë kohë për shqyrtim. Barnieri nuk ka pranuar të komentojë nëse është arritur mjaftueshëm përparim për të organizuar ndonjë samit të BE-së për Brexitin këtë muaj.



Bashkëpunim apo rivalitet pas zgjedhjeve në ShBA

Rezultati i zgjedhjeve për Kongres nga shumë analistë shihet si një vlerësim i ndarë i elektoratit për udhëheqjen e presidentit Donald Trump, i cili në Shtëpinë e Bardhë foli për mundësinë e bashkëpunimit me demokratët, të cilët tani kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve

UASHINGTON, 8 NËNTOR - Relievi politik ndryshoi këtë javë në Uashington pas rezultatit të zgjedhjeve për Kongres. Demokratët e opozitës kanë fituar shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, ndërsa republikanët kanë forcuar kontrollin në Senat. Rezultati nga shumë analistë shihet si një vlerësim i ndarë i elektoratit për udhëheqjen e presidentit Donald Trump. Presidenti Trump foli në Shtëpinë e Bardhë për mundësinë e bashkëpunimit me demokratët, të cilët tani kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve. "Dua të shoh bashkëpunim dypartiak. Dua të shoh unitet. Mendoj se shanset janë të mira, ndoshta jo në çdo temë, por gjithsesi ekzistojnë shanse të

mira për bashkëpunim", tha ai. Presidenti Trump i quajti meritë të vetën fitoret e republikanëve në Senat. "Mendoj se rezultatet që kam dëgjuar dhe besoj se do të konfirmohen, dëshmojnë se njerëzit më pëlqejnë mua dhe punën që po bëj", tha ai. Udhëheqësja e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, la të hapur mundësinë për bashkëpunim me presidentin mbi kujdesin shëndetësor dhe tema të tjera. "Do të përpiqemi për bashkëpunim dypartiak. Besojmë se e kemi për detyrë të identifikojmë pika të përbashkëta aty ku është e mundur. Aty ku është i pamundur bashkëpunimi, ne do t'u përmbahemi parimeve tona", tha ajo. Demokratët shprehen të



kënaqur me rezultatet në Dhomën e Përfaqësuesve, por të zhgënjyer nga humbjet në Senat. "Nuk ishte një valë e madhe ndryshimi siç ishte parashikuar. Kjo dëshmon se njerëzit nuk votojnë më së shumti për temat, por lidhur me presidentin Trump", tha ish-ligjvënësi Patrick Murphy. Pas zgjedhjeve të së martës, është i paqartë kursi që do të

marrë politika në Uashington, thotë analistja Karen Tumulty. "Kemi dëgjuar një vendim të përzier. U duk sikur dallga blu ndeshi në murin e kuq. Mendoj se aleatët e Amerikës nëpër botë do ta kenë shumë të vështirë të kuptojnë çfarë po ndodh përveçse do të shohin ngecje të përsëritura në Kongres", tha ajo. Analisti John Fortier thotë se nuk duhet të mendohet si i

pamundur një farë bashkëpunimi mes presidentit dhe demokratëve. "Ka gjëra që mund të arrihen me bashkëpunim mes demokratëve dhe republikanëve. Është e vështirë pasi të dyja palët kanë qëndrime diametralisht të kundërta. Megjithatë, ka gjëra që mund të realizohen, por jo agenda e presidentit", tha Fortieri.

Por presidenti mund të stepet nëse demokratët hapin procese hetimore mbi Shtëpinë e Bardhë, thotë politologja Molly O'Rourke. "Do të ndryshojnë shumë gjërat në presidencën Trump tani që demokratët kanë Dhomën e Përfaqësuesve, e cila ka mundësinë ta sfidojë presidentin në agjendën legislative, por edhe në mënyrën si udhëhiqet administrata", tha ajo. Pas zgjedhjeve për Kongres, presidenti Trump duket edhe se ka marrë zemër, por edhe sikur është vënë përballë një sfide të re. Por, ai duket i gatshëm për dy vjetet e fundit të mandatit të tij që besohet se do të sjellin beteja të forta politike.

Partitë e djathta evropiane zgjedhin kandidatin për zgjedhjet e majit



BRUKSEL, 8 NËNTOR - Ligjvënësi gjerman në Bashkimin Evropian, Manfred Weber, ka fituar garën për t'i udhëhequr partitë e qendrës së djathtë në zgjedhjet e BE-së që do të mbahen në muajin maj. Weber, po ashtu, do të jetë kandidat i Partisë Popullore Evropiane për t'u bërë president i Komisionit Evropian. Ai ka mundur ish-kryeministrin finlandez,

Alexander Stubb, në konferencën e partisë së mbajtur në kryeqytetin e Finlandës, Helsinki. Sipas të dhënave zyrtare të votimit, Weberi ka fituar përkrahjen e pothuajse 80 për qind të delegatëve. Ai ka qenë lider i Partisë Popullore Evropiane në Parlamentin Evropian nga viti 2014. Sipas parashikimeve, kjo parti pritet ta fitojë shumicën e ulëseve në

zgjedhjet e ardhshme në Parlamentin Evropian, andaj Weberi do të jetë në pozitë të favorshme për ta zëvendësuar Jean Claude-Juncker, i cili aktualisht mban presidencën në Komision Evropian. Ndërkohë, Partia Evropiane Socialiste ka nominuar gjatë kësaj jave nën-presidentin e këtij Komisioni, Frans Timmermans, kandidat për zgjedhjet e ardhshme.

Të shtëna në Kaliforni, të paktën 12 persona të vdekur

Uashington, 8 nëntor - Policia ka njoftuar për "disa viktime" si pasojë e të shtënave në një lokal në Thousand Oaks në Kaliforni. Sipas raportimeve, të shtënat kanë filluar të mërkurën në orën 23:20 (ora lokale) në zonën që gjendet rreth 65 kilometra në veriperëndim të Los Angelesit. Zyrtarët kanë konfirmuar se i

dyshuari është i vdekur dhe kanë thënë se sulmi ka rezultuar me të paktën 12 viktime. Sipas raportimeve, të paktën 200 persona kanë qenë brenda lokalit, meqë aty ishte organizuar një festë studentësh. "Kur ndihmësit kanë arritur, ata kanë dëgjuar të shtëna të vazhdueshme, sepse sulmuesi ka qenë aktiv", ka thënë zëd-

hënësi i sherifit të qarkut Ventura, Eric Buschow. "Ata kanë hyrë në lokal dhe mund t'ju them se ka viktime, të plagosur dhe në mesin e viktimeve është edhe një ndihmës i sherifit tonë që është përgjigjur në thirrjet fillestare, pa harruar edhe vrasësin", tha ai. Sipas policisë, numri i të plagosurve pritet të rritet.



Një libër që sjell mesazhe edukuese e këshilluese për fëmijë

(Avdi Shala, "Shtëpia në qiell", tregime për fëmijë, "Rozafa" Prishtinë, 2018)

Izet ABDYLI


Avdi Shala i ka dhuruar letërsisë shqipe një sërë librash për fëmijë të zhanreve të ndryshme, si: poezi, tregime, novela, romanë e drama, dhe tani vjen me librin e tregimeve "Shtëpia në Qiell", i 27-ti me radhë.

Një libër ku ndërthuren ëndrrat, dëshirat e gëzimet fëmijërore. Autori me lehtësi shtjellon idetë të cilat lindin krejt në mënyrë spontane qoftë nga dialogjet mes fëmijëve e prindërve, fëmijëve e mësuesit dhe fëmijëve mes veti. Autori ka arrit që t'u jep kuptim ngjarjeve duke sjellë mesazhe edukuese e këshilluese për fëmijët. Fantazia e shkrimtarit na sjell edhe komunikimin e fëmijëve me shtazët dhe shpezët por gjithmonë në funksion të nxjerrjes së porosive se si duhet evituar të keqen dhe përqaftuar të mirën. Edhe kur nganjëherë prindërit zihen në zgripç për t'u treguar ndonjë përrallë fëmijëve si rasti me tregimin për mollët, shkrimtari me imagjinatën e tij e nxjerr prindin nga situata dhe në vend të hidhërimit ai sjell buzëqeshjen e fëmijëve.

Edhe tregimi për dorën e zgjatur (Çka nuk guxon dora) është një këshillë universale për fëmijët se dora nuk duhet të futet kudo ngase kafshimi gjarprit është i rrezikshëm. Janë dhjetëra tregime ku shkrimtari udhëzon fëmijët për respektin që duhet të kenë për prindërit, të moshuarit, mësuesin etj. Në këtë libër na shfaqen edhe imazhe me koloritin e natyrës së bukur, gurgullimën e lumit, blerimin e natyrës, shkëlqimin e diellit, rrezatimin e hënës së bukur etj. Edhe rrëfimet e kohës së okupimit por edhe pasojat e luftës shtjellohen me mjeshtri. Veset e pamira si rrena, vjedhja, mashtrimi e krekosja zë vend në shumicën e tregimeve të autorit të librit. Ajo çka bien në sy në të gjitha këto tregime autori tejkalon situatat dhe dilemat që shtrohen në dialogjet prindër-fëmijë, shoku me shokun, fëmijë me kafshë apo gjallesa tjera, duke gjetur përherë rrugëzgjdhje, siç veprohet edhe me tregimin "Shtëpia në qiell" që është edhe titulli i këtij libri.

Me një fjalë brenda kopertinave të këtij libri ka vend për të gjithë, si: për gjyshin e gjyshen, vogëlushet me epitete zog,

pëllumb, fluturak etj, babushin e mamën, pastaj shtazë e shpezë si: kali, lepuri, macja, qeni, zogu, pëllumbi, shqiponja etj. Edhe bota bimore defilon si një pranverë e ylbhtë e mbushur me koloritin e ngjyrave përplotë hijeshi. Dora e poetit si me një magji shtrihet në të gjitha hapësirat e ambientet ku jetojmë duke mbledhur sikur bleta nektarin e dromcave të jetës e duke i kthyer në trajtë rrëfimesh për lexuesit e vegjël. Ndonëse libri ka 84 tregime dhe është konceptuar në dy pjesë që lenë të kuptohet se autori ka futur dy libra në një libër, larushia tematike e tregimeve bënë që lexuesin ta mbaj përherë kureshtar dhe përkundër volumit të madh ai të lexohet me kënaqësi. Përvoja krijuese e shkrimtarit ka bërë që ai të futet në botën e lexuesve të vegjël duke u servuar këtë libër çokollatë të cilën do ta shijojnë me ëmbëlsi. Arsenalin e fjalëve dhe gjuhë e folur është e natyrshme ndaj edhe lexuesit e vegjël me lehtësi do t'i "kapërdijnë" këto tregime. Me këtë libër autori po e pasuron fondin e letërsisë shqipe për fëmijë ku numri i krijuesve për fëmijë po shënon rënie.



MKRS-ja dhe UNICEF-i vazhdojnë bashkëpunimin në projektet për rininë

Prishtinë, (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të martën në kabinetin e vet, udhëheqësin e ri të zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin. Ministri Gashi fillimisht i ka uruar mirëseardhje dhe e ka falënderuar për vizitën e tij. Gjithashtu, Gashi e ka uruar Sahin për pozitën e tij të re si udhëheqës i zyrës së UNICEF-it në Kosovë dhe e ka falënderuar për gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar për realizimin e projekteve të përbashkëta për rininë.

Konkretisht në këtë takim u bisedua rreth vazhimit të bashkëpunimit të MKRS-së dhe UNICEF-it për krijimin e platformës për njohjen e punës vullnetare. "Në këtë platformë janë regjistruar mbi 3 000 vullnetarë dhe afër 100 OJQ. Duke parë suksesin e platformës për vullnetarë është paraparë edhe një platformë për ekstremizmin dhe radikalizmin ku dhënia e granteve do të jetë transparente", ka thënë Gashi.



Ndër të tjera, ministri e ka njoftuar udhëheqësin e UNICEF-it edhe për hapat që janë ndërmarrë nga ana e MKRS-së për përgatitjen e Strategjisë për Rini, draftin e të cilit tashmë MKRS-ja e ka të përfunduar.

"Realizimi i projekteve të përbashkëta me UNICEF-in konsiston edhe me politikat tona si ministri dhe ky bashkëpunim ka sjell sukses në aktivizimin e rinisë. Përmes realizimit të projekteve të tilla ne po përm-

bushim edhe zotimet tona për përfaqësim të interesave të rinisë së vendit", ka thënë ministri Gashi.

Ndërsa udhëheqësi i ri i zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, ka falënderuar ministrin

Gashi për pritjen e tij. Ai u shpreh i gatshëm për ta vazhduar punën e përbashkët në mënyrë që ky bashkëpunim të ndikojë në realizimin e projekteve për fuqizim të rinisë së Kosovës.

E rrallë

Dhurohen 8 000 pica për votuesit e uritur në radhë

Një grup dërgoi 8 000 pica për votuesit e uritur derisa prisnin në radhë të gjata për ta votuar pasditen e së martës në ShBA. Grupi "Pizza to the Polls" mbledh raportet e medieve sociale dhe nxjerr picat në përputhje me rrethanat. Katie Harlow ka thënë se ata do të japin pica edhe në vitin 2020 dhe do të synojnë ta bëjnë



këtë derisa njerëzit të mos presin më në qendrat e votimit.

FOTO E DITES



Punëtorët irakianë duke hequr me anije peshqit e ngordhur në ujë në lumin Euftrat në rrethin e Mussayabit në Irak. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Pensionisti në betejë ligjore për të qenë 20 vjet më i ri

Një pensionist holandez ka filluar një betejë ligjore për ta ndryshuar ligjërisht moshën e tij dhe për t'i rritur perspektivat e tij të takimit. Emile Ratelband dëshiron ta ndryshojë ditëlindjen nga data 11 mars 1949 në 11 mars 1969, duke e krahasuar ndryshimin me identifikimin si transgjedor. "Ju mund ta ndryshoni emrin



tuaj, ju mund ta ndryshoni gjininë tuaj, pse jo moshën?", ka thënë ai për "De Telegraaf". Pensionisti, gjithashtu, tha se do të heqë dorë nga pensioni në qoftë se i ndryshojnë datën e lindjes.

BARSOLETA E DITËS



Në aeroplan
- Zotërinj, piloti ju paralajmëron se aeroplani po rrëzohet dhe ju lutet t'i mbani pasaportat me dhëmbë, duke evituar kaosin e zakonshëm që ndodh për njohjen e kufomave.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross




Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

<p>DASHI Sot jeni shumë emotiv si pasojë e të gjithë padrejtësive që keni pasur kohët e fundit. Do të shpërtheni dhe do të dëgjoheni shumë qartë nga të tjerët.</p>	<p>DEMI Jeni komplet të papërgatitur për disa situata të caktuara, kështu që mos merrni përsipër iniciativa që nuk mund t'i finalizoni dot.</p>	<p>BINJAKËT Indiferenca ndonjëherë është arma më e mirë për të mos u lënduar, sepse jeta na rezervon çaste jo gjithmonë të këndshme.</p>	<p>GAFORRJA Instinkti juaj po ju sugjeron të ndryshoni komplet drejtim nga ai që jeni duke përkrahur momentalisht. Një zgjidhje përfundimtare për një problem të madh.</p>	<p>LUANI Doni pranë vetes aleatë të fortë për të përballuar një projekt të madh. Sot do të vendosni duke qëndruar në qetësi dhe vetëm me veten.</p>	<p>IRGJËRESHA Sot duhet t'u përgjigjeni shumë pyetjeve që kanë ngritur të tjerët karshi jush. Edhe pse kjo gjë ju bezdis, duhet t'i ndani njëherë e mirë gjërat.</p>
<p>PESHORJA Nëse sot do ta ruani autokontrollin, do të dini edhe se si të regulloni disa gabime të së shkuarës që ju kanë dëmtuar shumë.</p>	<p>AKREPI Projektet personale ose profesionale duan kohën e tyre që nuk duhet ta cenoni aspak me situata artificiale që në fund do t'ju dëmtonin veç juve.</p>	<p>SHIGJETARI Çastet e vogla që ju ofron dita duhet t'i merrni dhe t'i shfrytëzoni. Duke qëndruar pasiv nuk do të arrini askund.</p>	<p>BRICJAPI Edhe pse të heshur, sot do të arrini të dalloni qartë atë që ndodh në rrethin tuaj të ngushtë shoqëror. Mbase dhe ju duhet të pozicionoheni.</p>	<p>UJORI Mund të jeni vëzhgues të mirë, por kjo nuk do të thotë se mund ta ndryshoni rrjedhën e fakteve ose ngjarjet që verifikohen rreth jush.</p>	<p>PESHQIT Keni ide të bukura, por është mirë t'i zhvillonit dhe të mos i lini thjesht në teori. Pasi të qetësoheni nga disa probleme të vogla do të merrni me veten.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	SHEFF UTD - SHEFF WED	1	ABERDEEN - HIBERNIAN	1	LEVANTE - REAL SOCIEDAD	1
-------------------	-----------------------	---	----------------------	---	-------------------------	---

Ferizaj nuk largohet nga Superliga

Sulmuesi Dren Gashi është optimist se skuadra e Ferizajt, pavarësisht prej rezultateve jo të mira deri tash në Superligë, nuk do ta ketë problem mbijetesën. "Normalisht se kam besim të madh se Ferizaj nuk do të bjerë nga Superliga, pasi ka trajner dhe futbollistë cilësorë. Trajneri është duke bërë një punë të jashtëzakonshme, për çfarë nuk kam asnjë vërejtje. Ai kërkon maksimumin nga lojtarët për të fituar sa më shumë ndeshje. Cilësia dhe angazhimi nuk po mungon, por fati në disa raste po", ka thënë Gashi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - KF Ferizaj e ka regjistruar vetëm fitoren e katërt në ndeshjen ndaj KEK-ut dhe aktualisht pozicionohet në pjesën e poshtme të tabelës në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, por sulmuesi Dren Gashi është i sigurt se kjo skuadër do të mbijetojë në elitë. Ai ka thënë se edhe trajneri Afrim Tovërlani është duke bërë punë të mirë në skuadër. "Normalisht se kam besim të madh se Ferizaj nuk do të bjerë nga Superliga, pasi ka trajnerë dhe futbollistë cilësorë. Trajneri është duke bërë një punë të jashtëzakonshme, për çfarë nuk kam asnjë vërejtje. Ai kërkon maksimumin nga lojtarët për të fituar sa më shumë ndeshje. Cilësia dhe angazhimi nuk po mungon, por fati në disa raste po", ka thënë Gashi të enjten për "Epokën e re".

Njërin nga dy golat e shënuara në sfidën ndaj KEK-ut në Obiliq e realizoi ish-sulmuesi i Prishtinës, por ai është i kënaqur më shumë me tri pikët sesa me golin. "Ishte goli i tretë personal në këtë edicion, por më shumë jam i kënaqur me fitoren e arritur. Ne si klub jemi duke luajtur hapur në çdo lojë dhe kjo tregon se nuk kemi frikë nga kundërshtarët, por rezultatet e deritanishme nuk janë shumë reale për faktin se jemi paraqitur mirë në shumicën nga ndeshje dhe humbjet kanë ardhur për shkak të disa hollësive të vogla", ka shtuar ai. Lojën e radhës Ferizaj në kuadër të



javës së pesëmbëdhjetë sërish e luan si mysafir dhe kësaj radhe përballë e ka skuadrën e fuqishme të Feronikelit. Lidhur me këtë ndeshje sulmuesi Gashi ka deklaruar: "Kemi një kundërshtar të fortë përballë, por synimet tona janë që të rikthehemi nga Drenasi me rezultat pozitiv". Nga

katërmëdhjetë ndeshjet e zhvilluara, Ferizaj ka regjistruar katër fitore, një barazim dhe nëntë humbje. Aktualisht kjo skuadër pozicionohet e dhjeta me 14 pikë, një pikë me shumë se skuadra e parafundit dhe dy më pak se Trepça '89 që është e nënta në Superligë.

SHKURT

FFK-ja pritët ta fitojë të drejtën e dhënies së Licencës UEFA - B

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu dhe drejtorit teknik, Michael Nees, kanë pritur instruktorin e UEFA-s për edukim të trajnerëve, Dany Ryser. Gjatë këtij takimi u bisedua për punën e suksesshme që është bërë deri më tash në shkollimin e trajnerëve me Licencën C si dhe fillimin e kursit për Licencën B të UEFA-s. Po ashtu, u diskutua edhe për projektin e krijimit të qendrës edukative, derisa në mars të vitit të ardhshëm do të dorëzohet raporti i punës së deritashme në panelin e UEFA-s në mënyrë që FFK-ja ta fitojë të drejtën e dhënies së Licencës UEFA - B. Nga ana e tij Dany Ryser lavdëroi punën që po e bën FFK-ja në të gjitha segmentet.

Goli i Celinës më i miri për muajin tetor

Me 53 për qind të votave, Bersant Celina e ka fituar çmimin e golit më të mirë për muajin tetor për klubin e tij Swansea. Ai e shënoi këtë gol ndaj Ipswich Townit, ku mesfushori kosovar mori topin nga mesi i fushës, pastaj u afrua te goli dhe me një goditje të lehtë dërgoi topin në rrjetë. Ky ishte, po ashtu, goli i tij i parë me fanellën e skuadrës angleze në Championship (liga e dytë pas Premierligës). Golin e votuan fansat në faqen zyrtare të klubit. Mesfushori i Kosovës deri më tani i ka dy gola dhe 1 asistim.

Mourinho tregon pse i provokoi tifozët e Juventusit

Trajneri i Manchester Unitedit, Jose Mourinho, reagoi ashpër ndaj tifozëve të Juventusit në fund të ndeshjes dhe portugezi në konferencën për shtyp tregon gjithçka në lidhje me këtë rast. "Më kanë fyer për 90 minuta. Erdha këtu për ta bërë punën time, asgjë më shumë. Erdha si profesionist. Ndoshta nuk duhej ta bëja atë që bëra, nuk do ta kisha bërë nëse do të isha më i ftohtë. Por, ju them se për gjatë të gjithë ndeshjes, kam dëgjuar të shara në drejtimin tim, familjes sime dhe në drejtim të interistëve", ka thënë Mourinho.

Komuna e Prishtinës dyfishon buxhetin për sport

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Drejtori i Sportit në Komunën e Prishtinës, Fitim Rexha, ka takuar me radhë klubet sportive të kryeqytetit për t'u njoftuar nga afër me problemet e tyre dhe për t'i gjetur bashkërisht zgjidhjet. Drejtorja e Sportit, sipas një njoftimi, ka bërë me dije se ka për synim masivizimin dhe ngritjen e cilësisë në sport, duke ofruar përkrahje të

vazhdueshme për klubet, shoqatat dhe individët me aftësi të posaçme kreative, me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi. "Në kuadër të kësaj, për vitin e ardhshëm është dyfishuar buxheti për subvencionimin e sportit në Prishtinë. Komuna pret nga aplikuesit për subvencione seriozitet më të madh në prezantimin e projekteve të tyre, si dhe

do të kërkojë llogaridhënie për buxhetin e shpenzuar. Përgjatë këtyre takimeve u fol edhe për përzgjedhjen e sporteve të vitit, si dhe për mundësinë e plotësimit-ndryshimeve të kriterëve për subvencionim konform rregullores në fuqi", thuhet në komunikatë. Komuna e Prishtinës, përmes Drejtorisë për Sport, thotë se është e angazhuar që të krijojë



kushte sa më të mira për sportistët dhe sportistët e kryeqytetit dhe ka në plan t'i shtojë

investimet për ta përmirësuar infrastrukturën e këtij sektori të veçantë.

"Epoka e re" për fitore ndaj "RTK"-së, derbi mes "Lajmi.net" dhe "Media Works"

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Xhiroja e nëntë në Media Ligë do të jetë interesante. Ekipi lider, "Epoka e re", pas barazimit të papritur në ndeshjen e kaluar ndaj "Lajmi.net", tash synon fitore

ndaj "RTK"-së në mënyrë që ta vazhdojë dominimin në ligën e medieve të Kosovës. Ndërsa derbi i kësaj xhiroje zhvillohet në mes të "Lajmi.net" dhe "Media Works", dy ekipe që

synim kanë titullin e kampionit. Ekipi i dytë në tabelë, "Klan Kosova", do të luajë ndaj "D+", kurse ndeshje mjaft interesante pritet të jetë edhe ajo në mes të "KosovaPress"-it dhe "Gazeta


Metro"-s. Në takimet e tjera përballen: "Ora Info" - "InfoKosova & PrishtinaPost", "Gazeta Blic" - "Gazeta Zëri", "Kallxo.com" - "Telegrafi", "RTV Dukagjini" - "Infokusi".



Karateistët përfundojnë garat në Spanjë

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës në karate ka mbyllur garat individuale në Kampionatin Botëror që po mbahet në Madrid të Spanjës. Në një konkurrencë shumë të fortë garuesit tanë kanë garuar në kategori të ndryshme, me synimin për të fituar sa më shumë pikë olimpike për ta zënë normën olimpikë "Tokyo 2020".

Më i suksesshmi doli Alvin Karaqi në kategorinë -84 kilogramë. Karaqi fitoi tri luftëra, për t'u ndalur në luftën e katërt, nga turku Ugur Aktas, me pikë me epërsi, edhe pse rezultati ishte baras 2:2. Sipas Rregullores së pikëve Olimpikë të Federatës Botërore të Karatesë (WKF), Karaqi ka fituar 456 pikë olimpikë, bazuar në kuotën 12 që ka kampionati botëror, duke llogaritur këtu edhe pikët e pjesëmarrjes dhe renditjen nga pozita 15-33. Alvini ishte në mesin e 18 më të mirëve. Herolind Nishevcu në kategorinë +84 kilogramë shënoi dy fitore, për t'u ndalur në të tretën. Ai, përkundër se ishte i lënduar, arriti të realizojë dy fitore, duke shtuar kështu në llogarinë e vet edhe 300 pikë olimpikë. Dy fitore realizuan edhe Elhami Shabani (-75 kg) dhe Orges Arifi (-60 kg), të cilët njësoj si



Nishevcu fituan nga 300 pikë olimpikë. Pikët zyrtare WKF do t'i publikojë më 1 dhjetor 2018. Rruga për ta zënë normën olimpikë Tokyo 2020 për karateistët mbetet ende e gjatë. Në karate, kategoritë olimpikë të meshkujt janë: -67 kg, -75 kg, +75 kg dhe kata, ndërsa tek femrat: -55 kg, -61 kg, +61 kg. Dy karateistët tanë më të suksesshëm, Karaqi dhe Nishevcu, bëjnë pjesë në kategorinë e njëjtë olimpikë, +75 kg. Nga garuesit tjetër, me një fitore e

mbylli botërorin edhe Ylli Cenaj, në kategorinë -67 kg. Humbje në luftën e parë pësuan: Adelina Rama (-61 kg), Gresa Zhitia (-65 kg), Diellza Dragusha (-68 kg), Fortesa Orana (+68 kg), si dhe Vlerona Shala (kata) e Argjend Berjani (kata). Drejtësinë në këtë botëror po e ndajnë edhe tre gjyqtarët tanë me licencë ndërkombëtare: Ardian Muhadri, Besart Vítia dhe Besim Ilazi. Botërori ka filluar më 6 nëntor, ndërsa mbyllet më 11 nëntor.

Fitojnë Toronto, Lakersat, Miami dhe Oklahoma

TORONTO, 8 NËNTOR - Toronto konsolidon pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes, pas fitores 114-105 ndaj Sacramento, duke korrur fitoren e 11-të këtë sezon në NBA. Kanadezët e komanduan ndeshjen dhe e merituan fitoren, me Leonardin që realizoi 25 pikë e 11 rebaunde, mbështetur edhe nga Siakam me 21 pikë. Për Sacramento u dalluan Stein e Hield me nga 24 pikë secili, por që nuk u mbështetën sa duhet nga pjesa tjetër e skuadrës. Fitores i është gëzuar edhe Miami, që mundi 95-88 San Antonion, ndeshje në përgjithësi e komanduar nga skuadra nga Florida. Whiteside me 29 pikë e 20 rebaunde ishte shënuesi më i mirë për Miamin, ndërsa për Spursin nuk mjaftuan 18 pikë e 14 rebaunde të DeRozanit. Vijon sezoni interesant i skuadrës së lakersave, që mundën 114-110 Minnesotan, sfidë e ekuilibruar dhe me rivalitet deri në fund. LeBron James e mbylli me 24 pikë 10 rebaunde, mbështetur edhe nga Kuzma dhe Hart me nga 21 pikë secili si dhe Ingram me 20. New



Orleansi, falë 32 pikëve e 15 rebaunde të Davisit, mundi 107-98 Chicagon, duke korrur suksesin e pestë sezonal, ndërsa Utah Jazzi mundi 117-102 Dallasin, sfidë ku diferencën e bëri Mitchell me 23 pikë. Në takimet e tjera, Philadelphia fitoi 100-94 ndaj Indianas, me Embiid që realizoi 20 pikë e 10 rebaunde, ndërsa Memphis fitoi në konkordat e fundit 89-87 ndaj Denverit, takim ku diferencën e bëri Marc Gasol me 20 pikë e 12 rebaunde.

REZULTATET

Cleveland - Oklahoma	86-95
Orlando - Detroit	96-103
Atlanta - New York	107-112
Miami - San Antonio	95-88
Indiana - Philadelphia	94-100
Memphis - Denver	89-87
New Orleans - Chicago	107-98
Utah Jazz - Dallas	117-102
Sacramento - Toronto	105-114
Lakers - Minnesota	114-110

SHKURT

Kamza shkarkon trajnerin Klodian Duro

Skuadra e Kamzës e ka shkarkuar nga detyra e trajnerit, Klodian Duro. Lajmin e ka bërë me dije klubi me anë të një njoftimi në faqen zyrtare në "Facebook". Klubi bën të ditur mbylljen e bashkëpunimit me trajnerin Klodian Duro. Duke e falënderuar trajnerin për kontributin e tij të palodhur, përkushtimin dhe gjithçka dha për skuadrën tonë, bëjmë të ditur se rrugët tona ndahen këtu. Mungesat e rezultateve na detyrojnë të bëjmë një zgjidhje tjetër në këtë çast. Trajnerit Klodian Duro i urojmë suksese në karrierën e tij në vazhdimësi dhe e konsiderojmë gjithnjë pjesë të familjes", thuhet në njoftimin e Kamzës.

Ronaldo: Unitedi nuk bëri asgjë për ta fituar ndeshjen

Cristiano Ronaldo ka thënë se Manchester Unitedi nuk bëri asgjë për ta fituar ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Juventusit (1-2). "Ne dominuam për 90 minuta, kishim aq shumë raste, mund t'i kishim 'vrrarë' 3-4 herë, por ne u qetësuam dhe u ndëshkuam. Manchester Unitedi nuk bëri asgjë për ta fituar këtë ndeshje. Nuk mund të flisni as për fat sepse duhet të kërkohet fati dhe në këtë rast ne ua dhuruam atyre. Tani s' duhet ta vrasim mendjen, pasi luajtëm shumë mirë dhe jemi ende në krye të grupit", ka thënë Ronaldo, i cili e komentoi edhe golin e shënuar: "Sa për golin, pash pamjet filmike në dhomën e zhveshjes, nuk ishte një gol fantastik, por bëra një lëvizje të mirë dhe e godita topin fort".

Guardiola: Nuk mund t'i them lojtarit tim ta humbasë penalltinë

Manchester City shpartalloi Shakhtarin me rezultatin 6-0, megjithatë ajo që tërhoqi më shumë vëmendje ishte penalltia që gjyqtari Kasai dha në favor të skuadrës angleze. Ishte një nga 11-metërshat më absurd dhe normalisht edhe vetë Pep Guardiola pas ndeshjes e pranoi se nuk ishte një penallti, por ai nuk kishte mundësi që të fliste me gjyqtarin, por në asnjë mënyrë nuk mund t'i thoshte lojtarit të tij që të gjuante në trupin e portierit, për të mos shënuar. "Në momentin që shënuam e kuptuam se nuk ishte një 11-metërsh. Nuk pata mundësi të flas me gjyqtarin, por unë nuk mund t'i them lojtarit tim që të godasë në këmbët e portierit për të mos shënuar, edhe pse nuk na pëlqen që të shkojmë në këtë mënyrë", ka thënë Guardiola. "Ishte një performancë e pabesueshme për shkak të mënyrës se si kemi sulmuar dhe se si kemi mbrojtur. Nuk është e lehtë për ta bërë këtë. Ende nuk jemi të kualifikuar, por jemi shumë afër. Duhet të përpiqemi ta mbajmë këtë nivel dhe kjo do të na ndihmojë të qëndrojmë të fokusuar. Tani do të fillojmë të mendojmë për ndeshjen me Manchester Unitedin", ka deklaruar Guardiola.

Ramosi nuk ndryshon, ia thyen hundën lojtarit të Plzenit

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, nuk dorëzohet kurrë. Reali arriti të merrte një fitore të rëndësishme në Ligën e Kampionëve përballë Viktorias Plzenit me rezultatin 0-5. Në minutën e 13 ka ndodhur një episod që edhe mund t'i ndryshonte fatet e takimit. Ramosi godet me bërryl lojtarin Havel me një zgatje të dhunshme të dorës duke i thyer hundën kundërshtarit. Një bërryl i zgjatur që nuk është parë nga gjyqtari dhe spanjollit nuk është ndëshkuar as me të verdhë për këtë episod, megjithëse loja ka ndaluar për t'i ardhur në ndihmë futbollistit të Plzenit.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
 ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:593 /1
 Dt: 08.11.2018

Në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L -149, neni 12, paragrafi 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L.-138, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri shpallje e Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Departamenti: Drejtorati për fushat profesionale të AAP-së dhe ARr-së

Paga bruto: 423.85 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e profesional (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: gjatë (6) mujore

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon realizimin e aktiviteteve të AAAPAr-sc në bazë të planit vjetor dhe legjislativitetit në fuqi për punën profesionale.
- Në konsultim me stafin profesional dhe mësimdhënësit e shkollave partnere të marrë të dhëna të reja për zbatimin e kurrikulave, sfidave dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre.
- Të ndihmoj në organizimin e trajnimeve të mësimdhënësve të parapara sipas planit të veprimt.
- Të ndihmoj në organizimin e punëtorive, konferencave.
- Bashkëpunon ngushtë me stafin AAAPAr-së për çështje profesionale në AAP dhe komunikon me bartësit relevant brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e AAP-së.
- Kryen edhe punë tjera të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Përgjegjës për raportim të punës të përgjegjësi kompetent për dhënien e shënimeve dhe raporteve lidhur me të gjitha kërkesat e pranuar dhe për parregullsi e eventuale;
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access);
- Diplomë universitare .

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur (Ndërtesa MASH-T-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë), duke filluar nga ora 8.00 deri në orën 16.00 po ashtu aplikacionet e plotësuar, duhet të dërgohen në këtë adresë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO
 ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton për anulimin e konkursit të shpallur me datë 08.11.2018, me Nr. të Ref. 37/2018, për pozitën Zyrtar për Komunikim dhe Marketing në Qendrën Kinematografike të Kosovës, për shkak të procedurave të rekrutimit.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, na osnovu procedure zaposljavanja, obavestava o anuliraju konkursa objavljenog dana 08.11.2018, sa Br. Preporuke 37/2018, o poziciji Zvanicnik za Komuniciranje i Marketing u Centru Kinematografije Kosova, zbog procedure za regrutaciju.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Sapniq"- Sapniq

Komuna: Rahovec

Data: 09 Nëntor 2018

Emri i kontratës: Blerja e kamerave dhe mjeteve tjera përcjellëse dhe Llaptop

Numri i kontratës: ESIP/SDG/099 - ESIP/SDG/099-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe shkollën "Sapniq", Sapniq -Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Paisje me llaptop - 4 copë
- Paisje me kamera të sigurisë - 4 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishtëm teknik në adresën Adresa e Shkolles "Sapniq", Sapniq-Rahovec më së largu deri më 19 Nëntor 2018.

4. Specifikimi i hollësishtëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Xhafer Gashi

Telefoni: 044/767127

E-maili: msusigjaf05@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,
Ministri of Education, Science and Technology

Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 7 paragrafi 4 i Udhëzimit administrativ 10/2018 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe kërkesës së Qendrës Burimore, Departamenti për arsim parauniversitar, shpall;

KONKURS

Për vende të lira të punës në Qendrën Burimore për mësim dhe këshillim "Përparimi" Prishtinë

I. Dy (2) Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

I. Punët dhe detyrat për asistent/e për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore

- Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatit informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezenton punën dhe arritjet e nxënësve. Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;
- Kryen edhe punë të tjera që i përcakton drejtori.

Përgatitja shkollore

- Shkolla e mesme dhe niveli i 5 -të (post sekondar) i kualifikimit, asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Dëshmi shtesë për fazën e para seleksionimit

Certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHT, gjegjësisht vetëm ato që konsiderohen relevante për vendin e punës sipas konkursit.

Kushtet e konkursit

Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e kandidatëve
Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, Udhëzimi administrativ i MASHT nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Sqarim shtesë: – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuar dokumentet në MASHT.

– Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas Udhëzimit administrativ nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Formulari i aplikimit (merret në Qendër Burimore).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Dëshmi që nuk është nën hetime.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore përkatëse ku konkurrojnë.

Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,
Ministri of Education, Science and Technology

Na osnovu Zakonu o radu br. 03 / L-212, Zakon o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, član 7, stav 4 Administrativne uredbe 10/2018 o Normativu o profesionalnom okviru opšteg obrazovanja, Administrativne uredbe br. 02/2018 o Resursnim centrima, Administrativna uredba br. 07/2017 o regulisanju procedure konkursa u javnom sektoru i zahtevu Resursnog centra, Departament za preduniverzitetsko obrazovanje, objavljuje;

KONKURS

Za slobodna radna mesta u Resorsnom centru za učenje i savetovanje "Përparimi" Priština

I. Dva (2) Asistenta/ce za decu sa posebnim obrazovnim potrebama

II.

I. Poslovi i zadaci asistenta/ce za decau sa posebnim obrazovnim potrebama

- Pomaže deci /učenicima u razvoj i promovisanju samostalnost, orijentaciji i mobilnost, transport, položaji i sedenje učenika u učionici;
- Radi sa nastavnicima i drugim osoblje na implementaciju IPO-a, individualizovanih predmeta ili učenje u atraktivnim oblastima;
- Priprema nastavne materijale kao i menadžira sa potrebnom opremom unutar i van učionice.
- Posmatra i dokumentuje identifikovane poteškoće i potrebe dece, priprema povratne informacije o poteškoćama i dostignućima dece;
- Promoviše inkluzivno obrazovanje i prihvatanje sva deca u razred, podstiče decu u komunikaciji, za učešće u igri i stimuliranjem govora i jezika kroz razgovor i igru;
- Nadgleda i pomaže deci /učenicima tokom obroka, stara se za fizičku i lekarska potrebu učenika i pomaže u oblačenju i njihovu opštu higijenu;
- Planira sa učiteljem/učiteljima dnevni nedeljni program učenja, aktivnosti i događaji u cilju podrške dece u učenju;
- Promoviše saradnju škola-kuća, podržava i razgovara o osetljivim pitanjima sa roditeljima/starateljima;
- Poštuje pravila i školsku etiku, dobro ponašanje prema učenicima;
- Predstavlja rad i dostignuće učenika. Informacije u školi tretira kao apsolutno poverljivim;
- Obavlja i druge poslove koje mu odredi direktor.

Školska sprema

- Srednja škola 5-ti nivo (post sekondarno) kvalifikacije, asistent za decu /učenika sa posebnim obrazovnim potrebama.

Dodatni dokaz za pred selektivnu fazu

Certifikati za obuke akreditovane od strane MONT-a, odnosno, samo one koje se smatraju relevantnim za radno mesto prema konkursu.

Uslovi konkursa

Uslovi i kriterijumi za odabir kandidata

Odabir kandidata se vrši na osnovu zakonskih kriterijuma koji uređuju oblast obrazovanja: Zakon o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, br. 04/L-032, Administrativne uredbe MONT-a br. 10/2018 o normativu stručnog kadra za opšte obrazovanje.

Dodatna objašnjenja: – Podaci predstavljeni u aplikaciji smatraju se važećim samo ako su dokumentovani dokazima – Osobe koje su diplomirale van Kosova mora da imaju dokumenta nostrifikovana u MONT.

– Na pismenom intervju biće pozvani kandidati koji ispunjavaju kriterijum konkursa prema Administrativnoj uredbi br. 10/2018 za normativ o stručnom kadru za opšte obrazovanje.

Kandidati koji apliciraju treba da su državljane Republike Kosova.

Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dan objavljivanja konkursa u javnim medijima informisanja.

Aplikacioni formular (možete dobiti u Resorsnom centru).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Dokaz da nije pod istragom.

Kandidati, moraju dostaviti dokumenta u relevantan Resosni centar u kojem konkurišu. Nekompletirane aplikacije neće se razmatrati.

REGIONAL CENTER FOR MENTAL HEALTH SERVICES
 QENDRA E SHËNDETIT MENDOR ME SHTËPITË PËR INTEGRIM NË BASHKËSI-PRIZREN
 COMMUNITY BASED MENTAL HEALTH CENTRE AND HOUSES FOR INTEGRATION-PRIZREN
 No. Prot. 07/02
 Data 08.11.18
 No. faqes 4
 No. pages 4



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
 Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi -Prizren
 Community based Mental Health Centre and Houses for Integration-Prizren
 Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, nenit 13 pika 5 dhe nenit 18 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Qendra Klinike Universitar e Kosovës, (SHSKUK), si dhe nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi, dhe aprovimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së të datës 19.09.2018, të kërkesës nr. 60/01 të datës 18.09.2018; Drejtori i Qendrës së Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim-Prizren shpallë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i pozitës së punës: Infermier-e një pozitë (1)
Njësia: Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi-Prizren
Kohëzgjatja e kontratës: Sipas legjislacionit në fuqi
Koeficienti: (5.4)(4.8)
Orari: 1 plotë /40 orë në javë
Nr i Referencës: QSHM-SHIB-06/11/18

I. Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë së përgjithshme:

- Do të punojë si pjesëtarë të ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit më të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët.
- Zbaton politikat integruese dhe udhëzimet organizative për standardet profesionale.
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe shërbimin ku punon.
- Të caktojë, planifikojë, zbatojë dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politiken e aprovuar.
- Merr pjesë në zhvillimin profesional / zhvilluar praktikën infermierike.
- Sipas nevojës të asistojë pacientin në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit.
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientet dhe kolegët.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/saj të punës.
- Të u afro pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre.
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punoj gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit.
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politiken Institucionale.
- Të ndërmarë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit.
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet.
- Të asistojë në hartimin e udhëzimeve procedurave të shkruara mbi punën e infermiereve.
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit sipas specifikave të shërbimit.
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor.
- Të ruajë konfidencialitetin të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politiken Institucionale.
- Gjithnjë të veprtojë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonite në avancimin e marrëdhënies të mira pacient - infermier/e.
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike.
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë.
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezulttit të kujdesit ndaj pacientit.
- Lehtëson koordinimin e kujdesit për të arritur rezultatet e shëndetit.
- Zbaton protokollet e praktikave infermiere të bazuara në dëshmi, gjatë ofrimit të kujdesit infermieror.
- Përdor dhe kontribuon në hulumtime që ndërlidhen me dëshmitë për siguri dhe praktikën efektive dhe efiziente.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike :

- Infermieri është përgjegjës për detyrat e tij/saj të përshkruara në Qendër të Shëndetit Mendor dhe në Shtëpinë Integruese.
- Të punojë në koordinim me profile të tjera profesionale (psikiatrin, punëtorin social, këshilltarin psikosocial, psikologun etj.) në Qendër të Shëndetit Mendor dhe Shtëpinë Integruese duke u bazuar në principet e punës në ekip: në intervenime dhe aktivitete me klientë (individuale dhe në grup, aktivitete psiko-edukative, në punë me familje, vizita shtëpiake, aktivitete rekreative-sportive dhe aktivitete rehabilituese).
- Infermieri duhet të respektoj konfidencialitetin profesional gjatë punës së tij.

Kushtet e kërkuara- Shkollimi i duhur - fotokopje:

- Diploma e Fakultetit të Infermierisë - drejtimi përgjithshëm,
- Diploma e shkollimit të mesëm-technik infermier-e-drejtimi i përgjithshëm.
- Certifikata e licencimit për punë e lëshuar nga MSH e Republikës së Kosovës,
- Certifikata nga libri amzë i të lindurve
- Leje njoftimi – fotokopje,
- Leje për vozitje (patent shoferi) – e dëshirueshme,
- Njohja e gjuhës angleze – e dëshirueshme,
- Njohja e kompjuterit (word dhe excel) – e dëshirueshme,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisimit, rekomandime, etj.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.
 Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.
 Përparësi në rastin e përzgjedhjes do të kenë kandidatët me kualifikime të veçanta në shëndet mendor.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit

Paragjithësi e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Administratës në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren. Në aplikacion duhet të cekët qartë titullin e vendit të punës dhe numrin e referencës. Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 029/623931.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.


Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Prizren, 08.11.2018



Drejtori
Dr. sc. Naim Panaj

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
 Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi -Prizren
 Community based Mental Health Centre and Houses for Integration-Prizren
 Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren

Prema članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Administrativno Uputstvo br 14/2011 o Regulisanju Procedure Osnivanja Radnih Odnosa u Javnom Sektoru, člana 13 tacka 5. i člana 18. Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), člana 16. Statuta Kliničkog Univerzitetski Centra Kosova, kao i član 62, stav 6. Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvu, Kao i Odobrenje od strane Generalnog Direktora UBKSK od 19.09.2018, godine, prijave br. 60/01 od 18.09.2018; Direktor Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici - Prizren, objavljuje ovog:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Medicinski tehnicar (opšti smer Bachelor) jedna pozicija
Institucija: Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren
Trajanje ugovora: Prema važećim zakonima
Koeficijent: (5.4) (4.8)
Raspored: Pun / 40 sati nedeljno
Referentni br. QSHM-SHIB-06/11/18

I. Opis poslova i oblasti odgovornosti za medicinske sestre-tehničare (Bachelor) opšti smer:

- Da radi kao član tima za medicinske nege u pružanju najviši standard zdravstvene zaštite koja je fokusirana na pacijenta, obezbeđujući u svakom trenutku pravilnu i sigurnu negu za pacijente.
- Sprovedenje politike i smernice organizacione integracije za profesionalne standarde.
- Da sprovodi specifične profesionalne aktivnosti i usluge u struci u kojoj radi.
- Da odredi, planifikuje, implementira plan i evaluaciju brigu o pacijentima u skladu sa odobrenim politikama.
- Učestvuje u profesionalnom razvoju / razvoj sestriinske prakse.
- Ako je potrebno da se pomogne pacijentu u okviru lične higijene, tokom hranjenja, izvođenja fiziološke potrebe i druge aktivnosti koje promovisu zdravlje i dobrobit pacijenta.
- Da doprinese stvaranju bezbednog kliničkog ambijenta za sve pacijente i kolege.
- Da bi se osigurala dobra komunikacija tokom primopredaje dužnosti i tačne informacije za pacijente za kojima se brine tokom njenog rada.
- Da nudi pacijentima tačne i jasne informacije o njihovom zbrinjavanje .
- Da doprinosi održavanju čistoće i higijene u radnoj okolini u skladu sa svim smernicama o kontroli infekcije.
- Da upravlja tretman propisan u skladu sa institucionalnom politikom.
- preduzime sve neophodne mere za sprečavanje dekubitusa
- Da upotrebi i održava pravilno i sigurno sa svu opremu.
- Da asistira i pomogne u razvoju pisane procedure kojima se rukovodi u rad medicinskih sestara.
- Učestvuje u timskim sastancima u skladu sa specifikacijama službe.
- Učestvuje u aktivnostima koje organizuju pojedine programe jedinica u cilju razmene znanja i informacija među zdravstvenim osobljen.
- Održavanje i sacuvanje konfidencijalnosti koji se have lečenju pacijenta ili rad institucije, osim ako ona / on je ovlašćen u pisanoj formi, u skladu sa institucionalne politike.
- Uvek deluje na način koji bi pomogao u promovisanju dobrih odnosa pacijenta – sestre medicinskog tehnicara
- Učestvuje u radu kontinuiranog profesionalnog obrazovanja u cilju obnavljanja i unapređenja znanja i standarda sestriinske rada.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa nadzornikom da obezbedi visoku efikasnost na poslu.
- Obavlja posao i saraduje sa drugim zdravstvenim stručnjacima koji koriste mehanizam za praćenje ishoda brige o pacijentu.
- Olakšati koordinaciju nege za postizanje zdravstvenih ishoda.
- Implementira protokole sestriinski praksa bazirane na osnovu dokaza, tokom pružanje nege.
- Koristi i doprinosi rezultatima istraživanja u vezi sa bezbednošću dobre i efikasne prakse.

II. Specifični zadaci i obaveze:

- Odogovorani za svoje opisane dužnosti u Centru za mentalno zdravlje i Integrirani dom.
- Radi u koordinaciji sa drugim profesionalnim profilima (psihijatar, socijalni radnik, psihosocijalni savetnik, psiholog itd.) U Centru za mentalno zdravlje i Domu za integraciju zasnovane na principima timskog rada: intervencije i aktivnosti sa klijentima (individualni i grupne aktivnosti, psiho-obrazovne aktivnosti, porodični rad, kućne posjete, rekreativno-sportske aktivnosti i rehabilitacione aktivnosti).
- Poštuje profesionalnu poverljivost tokom svog rada.

Potrebno obrazovanje :

- Diploma bachelor fakulteta Med.tehnicar – opšti smer,
- Diploma srednje medicinske škole - opšti smer,
- Potvrda o Licenciranju za rad u Ministarstvo za zdravlje Republike Kosova,
- Izvod iz matične knjige rođenih
- Licna karta - fotokopirana
- Vozačka dozvola - poželjan,
- Poznavanje engleskog jezika - poželjan,
- Poznavanje rad sa kompjuterom (word i excel) – poželjan,
- Takođe može da dovede i druge dokaze o obuku, preporuke, itd
- Dokumentacija u prilogu prijave ne vraća se.
- Original ovih dokumenata ili notarom overenih biće potrebno samo kada je kandidat pozvan da radi.
- Prioritet u odabiru imaće kandidati sa posebnim kvalifikacijama u mentalnom zdravlju.

Uslovi učesća u zapošljavanju: pravo da se prijave imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu pravnu sposobnost, onih koji su završili svoje obrazovanje i imaju adekvatnu stručnu sposobnost za obavljanje zadatka.

Procedure ucesca na konkurs: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.


Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Podnošenje prijave: Prijave se uzimaju i dostavljaju u kancelariju Administratore u Centar za Mentalno Zdravlje u Prizren. U prijavi treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruzi aplikaciju, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa, ili ne donose nikakve dokaze o kvalifikacijama, neće biti pozvani na intervju. Kontakte mozete preko telefona 029/623931.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune prijave neće biti prihvacene.

U slučaju velikog broja primljenih zahteva, samo uzi izbor kandidata bice kontaktiranih.

Prizren, 08.11.2018



Direktor
Dr. sc. Naim Panaj

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760

MOMENTI YT

Premia kryesore
1X BANESË

1X BMW X6 **3X VW T-ROC**

Ky është **MOMENTI YT** për të fituar një nga **100 MEGA-DHURATAT**, me premitë kryesore **BANESË NË QENDËR TË PRISHTINËS** dhe **BMW X6**.

Hyni në lojë tani duke aktivizuar pakon me **5GB**, duke thirrur kodin ***100#**.
Pako kushton 2.5 Eur dhe ka validitet 10 ditë.

Dhuratat tjera që ju presin janë: **3xVW T-ROC**, **8x iPhone XS**, **8x iPhone XR**, **8x Samsung Galaxy Note 9**, **8x Samsung Galaxy S9**, **8x PS4 PRO**, **8x Samsung Tablet**, **4x Laptop Dell**, **16x 500 €**, **27x 200 €**.

Përzgjedhja e fituesve do të bëhet drejtpërdrejt në programin e pasditës në **T7**, çdo dy javë duke filluar nga **12 nëntor 2018**.

Sa më shumë aktivizime të pakos që bëni, aq më shumë mundësi keni për të fituar!

